

KONSULTIM ME PUBLIKUN

‘PIKE FURNIZIMI ME KARBURANT, KLEIDI’



SUBJEKT ZHVILLUES:

“KLEIDI” SH.P.K.

Ligji nr. 10440 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”, i ndryshuar, Shtojca II,
pika 10/b

PASQYRA E LENDES

1 HYRJA

1.1 PERSHKRIMI I PROJEKTIT

1.2 KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

2 PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES KUPROPOZOHET TE ZBATOHET PROJEKTI

3 INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE, NESIPERFAQEN E KERKUAR NGA PROJEKTI DHE NE AFERSI TE TIJ

4 INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE MUNDSHME, NEGATIVE, NE MJEDIS, TE PROJEKTIT

5 PERSHKRIMI PER SHKARKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS

6 TE DHENA PER SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPESINORE TENDIKIMIT NEGATIV NE MJEDIS

7 MASAT E MUNDSHME PER SHMANGIEN DHE ZBUTJEN ENDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS;

8 NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDISIN NDERKUFITAR (NESE PROJEKTI KA NATYRE TE TILLE).

9 PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

1. HYRJA

1.1 PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Ky vleresim i ndikimit ne mjedis do te paraqese nje informacion te shkurter te projektit qe do te realizohet, ndikimet pozitive dhe negative ne mjedis dhe masat qe investitorido te marre per zbatimin e kriterëve te nevojshme per mbrotjen dhe menaxhimin same racional te mjedisit.

Theksojme se shume nga vleresimet e detajuara te ndikimeve te mjedisit mbeshteten ne informacionet inxhinierike qe duhet te merren parasysh. Vleresimi identifikon ne menyre te qarte si perfitimet pozitive edhe negative dhe percakton "rezultate te pergjithshme" per secilen prej tyre. Vleresimi identifikon nese ndikimet jane mesatarete pranueshme, te rendesishme, te terthorte apo te drejtperdrejta.

Objekti i kesaj hyrje - permbledhje per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis te ndertimit te objektit ne studim:

- Te minimizojë streset ne mjedis dhe ne radhe te pare ne elementet prioritare si ruajtja e tokes, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilesise se ujit dhe ajrit
- Te ruaje ose rehabilitoje mjedisin natyror permes elementeve te reja te nderhyrjes pozitive, punimeve te vecanta ne kuader te projektit ose paralel me te, te cilet sigurojne vijueshmerine e qendrueshme te mjedist biologjik duke perfshire faunen dhe floren ne mjediset perreth zones se marre ne konsiderate.

- Qellimi i projektit te propozuar

Qellimi i projektit te propozuar

Qellimi i zhvillimit te aktivitetit eshte furnizimi me karburant i mjeteve.

Vendodhja e zhvillimit te projektit

Aktiviteti i furnizimit me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant, do te zhvillohet ne pasurine me nr. 5/301-N3, Zona Kadastrale 8240, ne pronesi te shoqerise GKAM sh.p.k, e cila **ka lidhur kontrate qeradhenie me shoqerine "Kleidi"sh.p.k. Kapacitet depozitimi 69 000 litra karburant, me siperfaqe 717.6m²**

Aktiviteti i perket fushes se hidrokarbureve dhe kryesisht shitjes (tregtimit) me shumice dhe pakice te karburanteve,t e naftes bruto dhe/ose nenprodukteve te saj (benzines, gazit, vajrave lubrifikante dhe filtra per mjetet e transportit).

- Impianti gaz auto

Gazi i lenget, shkurtimisht GLN, eshte nje perzierje hidrokarburesh nder te cilet kryesoret jane propani dhe butani.

Keto dy gaze kthehen ne gjendje te lenget, pasi jane vene nen presione jo shume te larta dhe ne temperature te ulet. Te kthyer ne gjendje te lenget, keto gaze jane lehtesisht te transportueshem, duke perdorur pajisje te posacme nen presion (autocisternat).

Ne kohet e sotme, ne kuader te zhvillimit te pergjithshem te ekonomise dhe ne vecanti te transportit automobilistik, gazi i lengezuar i naftes (GLN) perfaqeson nje komponent te rendesishem, ne rritje te shpejte te perdorimit dhe kjo per arsye se:

- Eshte i lehte per t'u transportuar, kudo ka nje rruge ku mund te dergohet.
- Ploteson cdo kerkese, ne fakt mund te perdoret nga ngrohja shtepiake ne ate industriale dhe si karburant.
- Ka nje fuqi te larte kalorifike, duke djegur 1kg GLN merret nje sasi energjie e barabarte me 14kw energji elektrike.
- Ekologjike, nuk ben tym, nuk le mbetje, nga djegia e tij nuk clirohen mbetje qe ndotin mjedisin.

Gazi i lenget (GLN) depozitohet ne ene te posacme (rezervuare ose bombola), te ndertuara posacerisht per t'u instaluar lehtesisht dhe me nje impakt mjedisor minimal. Gama e zgjidhjeve eshte shume e gjere dhe shkon nga rezervuaret mbitokesore horizontale deri tek rezervuaret nentokesore me veshje polietileni.

Objekti ndodhet ne Rrugen e Kavajes, Zona kadastrale 8240, pasuria me numer 5/301-N3. Ne foton e meposhtme tregohet vendndodhja e instalimit (burimi ASIG).

Koordinatat e nenobjekteve sipas sistemit koordinativ GAUSS KRUGER

| | |
|----------------------|--------------------------------|
| <u>PIKA 1</u> | X: 4398149.11 Y: 4576856.78 |
| <u>PIKA 2</u> | X: 4398176.69 Y: 4576868.36 |
| <u>PIKA 3</u> | X: 4398189.94 Y: 4576839.5 |
| <u>PIKA 4</u> | X: 4398160.83 Y: 4576828.64 |

Menaxhimi i pronave

Projekti kalon ne zonat kadastrale me numer: 8240 (referuar hartes semeposhtme, burimi: ASIG)

1.2 KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

Procesi i hartimit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM), ndihmon ne permiresimin e cdo lloj projekti ne respektimin dhe mbrojtjen maksimale te mjedisite zones ku ai zbatohet.

Qellimi i VNM-se eshte qe te siguroje qe mjedisi ne zonen ku zbatohet projekti do te konsiderohet i lidhur me gjithë ceshtjet e tjera te rendesishme, ne cdo etape te tij.

Ky raport eshte hartuar bazuar ne legjislacionin mjedisor ne fuqi dhe ka per qellim te identifikojë, parashikojë dhe vleresojë gjithë ndikimet e mundshme ne menyre sistematike, te kuptueshme dhe objektive.

VNM-ja eshte vleresimi mjedisor ne nje proces vleresimesh (te mjedisit, planifikimit hapasinor, ndertimit, etj.) qe eventualisht mund te finalizohet me Lejen e Zhvillimit.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis ne fakt i pergjigjet ne thelb ketyre pyetjeve kyc:

Si do te ishte mjedisi pa projektin? (per shembull Studimet Baze). Kjo do te identifikojë dhe pershkruajë gjendjen aktuale te burimeve dhe karakteristikat ekzistuese ne mjedisin qe mund te ndikohet nga projekti dhe se si keto do te zhvillohen ne mungese te projektit.

A. Cfare do t'i ndodhe ne mjedisit, si pasoje e projektit? (per shembull Parashikimi). Kjo do te pershkruajë mjedisin sic eshte pa projektin dhe se si ai do te ndryshojë si pasoje e projektit ne aspektin e burimeve mjedisore apo njerezve (receptoret) qe jane te ndikuar, natyren dhe shkallen e ndryshimit, shtrirjen e tij gjeografike dhe kohore.

B. A perben kjo nje shqetesim? (per shembull Vleresimi) Parashikimi i ndikimit nuk

eshte i mjaftueshem.

C. Nese eshte i rendesishem a mund te bejme ndonje gje ne lidhje me te? (per shembull Zbutja). Se fundi, eshte e rendesishme te kuptohet se, ne qofte se ndikimi eshte i rendesishem, mund te behet dicka per te shmangur, reduktuar, korrigjuar apo kompensuar per te. Zhvilluesi i projektit mund t'i perfshije keto masa zbutese ne propozimete projektit dhe autoriteti kompetent mund t'i perfshije kerkesat perkatese ne kushtet e lejes sedhene.

Ne menyre qe autoritetet kompetente dhe pale te jashtme te interesuara te vendosin nese projekti duhet te vazhdoje, eshte thelbesore qe informacioni mjedisor i dhene nga zhvilluesi ne Raportin e VNM-se, t'i pergjigjet ne menyre teqarte pyetjeve te mesiperme. Qellimi i studimeve te VNM eshte qe te gjenerojedhe paraqesekete informacion nemenyre te qarte, koherentedhe te sakte.

Idea e VNM-se eshte te siguroje informacion per vendim marresit dhe publikun mbi pasojat mjedisore te zhvillimeve te reja te propozuara. Per me teper ideja eshte qe te promovohet zhvillimi qe respekton mjedisin permes identifikimit te masave te duhura forcuese dhe zbutese.

Objektivi kryesor i VNM-se eshte te identifikojedhe ndikimet e mundshme negative mjedisore te projekteve te reja te zhvillimit. Brenda ketij qellimi, procesi i VNM-sekerkon qe:

- te konsiderohen alternativat per vendndodhjen dhe ndikimet mjedisore shoqeruese;
- te permiresohet plani mjedisor i propozimit;
- te sigurohet qe burimet jane perdorur si duhet dhe ne menyre eficente;
- te identifikohen masat e duhura per zbutjen e ndikimeve te mundshme te propozimit;
- te vendosen kushtet per ndertimin; dhe
- te ndihmohet vendim marrja dhe informimi i publikut.

Procedura e VNM-se perfshin:

- a. procesin paraprak te VNM-se;
- b. procesin e thelluar te VNM-se.

Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM) shyrton kerkesat per vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe ne fund te seciles procedure, paraprake apo te thelluar te VNM-se, merr Vendimin per VNM-ne paraprake, ndersa per VNM-ne e thelluar pergatit Deklaraten Mjedisore me rekomandimet perkatese dhe i'a degon Ministrise.

Ne perfundim vendim marrja konsiston ne:

- Vendim - leshuar nga AKM-ja ne perfundim te procedures paraprake te VNM-se

- Deklarate Mjedisore - leshuar nga Ministri ne perfundim te procedures sethelluar te VNM-se

Vendimi

Vendimi i AKM-se ne fund te procedures Paraprake te VNM-se percakton nese nje projekt i listuar ne Shtojcen II te Ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, ne fuqi, duhet apo jo t'i nenshtrohet procedures se thelluar te VNM-se. Nese AKM-ja vendos se projekti nuk duhet t'i nenshtrohet procedures se thelluar te VNM-se, ne vendimine saj percakton arsyet dhe konsideratat kryesore ku eshte mbeshtetur mendimi, mendimin e institucioneve te konsultuara, pershkrimin sipas rastit, te masave kryesore qe duhen marre per te shmangur, reduktuar dhe nese eshte e mundur per tekorrigjuar ndikimet negative te mundshme ne mjedis.

Deklarata Mjedisore

Rezultati perfundimtar i procedures se thelluar te VNM-se, eshte Deklarata Mjedisore, e cila mund te permbaje refuzimin ose miratimin me rekomandime per Autoritetin e Planifikimit per te vazhduar procesin ne baze te kushteve te specifikuara mjedisore.

Deklarata mjedisore sherben si dokument orientues per Autoritetin e Planifikimit dhe/ose cdo autoritet pergjegjes ne procesin e vendim marrjes, per nje leje zhvillimi apo per nje leje te caktuar per miratimin e nje projekti te listuar ne Shtojcat 1 dhe 2 te ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, ne fuqi.

Dokument i baze ku mbeshtetet procesi i VNM-se, eshte raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis, i cili ne varesi te ndikimeve te mundshme te projektit mund te jete:

- a. raport paraprak i VNM-se per projektet e shtojces II te ligjit nr. 10440, date 07.07.2011 'Per vleresimin e ndikimit ne mjedis' te ndryshuar;
- b. raport i thelluar i VNM-se per projektet e shtojces I te ligjit nr. 10440, date 07.07.2011 'Per vleresimin e ndikimit ne mjedis' te ndryshuar.

Baza ligjore

1. Ligji nr. 10431, date 09.06.2011 'Per mbrojtjen e mjedisit', te ndryshuar;
2. Ligji nr. 10440, date 07.07.2011 'Per vleresimin e ndikimit ne mjedis', te ndryshuar;
3. Ligji nr.10006, date 23.10.2008 "Per mbrojtjen e faunes se eger"
4. Ligji nr. 8906, date 6.6.2002 "Per zonat e mbrojtura" ndryshuar me ligjin, Nr.9868, date 4.2.2008 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8906 date 6.6.2002 "Per zonat e mbrojtura"
5. Ligji nr.10 253, date 11.3.2010 "Per gjuetine"

6. Ligji Nr. 9533, date 15.5.2006 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9385, date4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
7. Ligji Nr. 9791, date 23.7.2007 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9385, date4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
8. Ligji Nr. 15/2012, Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9385, date4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
9. Ligji Nr. 36/2013, Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9385, date4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
10. Ligji Nr. 38/2013 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9693, date 19.03.2007 "Per fondin kullosor te ndryshuar"
11. Ligji Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
12. Ligji nr. 68/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9587, date 20.7.2006, "Per mbrojtjen e biodiversitetit", te ndryshuar.
13. Ligji nr. 162/2014 "Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis"
14. VKM nr. 686, date 29.07.2015 "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve perzhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis(VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit dhe deklarates mjedisore";
15. VKM nr. 247, date 30.04.2014 "Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore"
16. Ligji nr. 10 463, date 22.9. 2011"Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", te ndryshuar;
17. VKM nr. 575 date 24.06.2015 "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte"
18. VKM nr.175, date 19.1.2011 "Per miratimin e strategjise kombetare te menaxhimit te mbetjeve dhe te planit kombetar te menaxhimit te mbetjeve"
19. VKM nr. 371, date 11.06.2014 "Per percaktimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe miratimin e dokumentit te dorezimit te mbetjeve te rrezikshme"
20. VKM nr. 418, date 25.06.2014 "Per grumbullimin e diferencuar te mbetjeve ne burim"
21. VKM nr. 229, date 23. 04. 2014 "Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe te dokumentit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme"

22. VKM nr.519, date 30.6.2010 “Parqet Natyror Rajonal”
23. Vendim Nr. 22, date 9.1.2008 "Per caktimin e procedurave dhe te kritereve te administrimit te pyllit komunal"
24. Vendim Nr. 1354, date 10.10.2008 "Per rregullat dhe procedurat qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullisor"
25. Vendim Nr. 396, date 21.06.2006 "Per kriteret e transferimit dhe te perdorimitte pyjeve nga njesite e qeverisjes vendore"
26. VKM nr.897. date 21.2.2011 “Miratimi i Rregullave per Shpalljen e Zonave te Vecanta te Ruajtjes”
27. VKM nr. 532, date 05.10.2000 “Per miratimin e studimit “Strategjia dhe Plani i veprimit per biodiversitetin”
28. VKM nr. 676, date 20.12.2002 “Per shpalljen zone e mbrojtur te monumenteve te natyres shqiptare”
29. VKM nr. 594, date 10.09.2014 "Per miratimin e Strategjise Kombetare percilesine e ajrit te mjedisit"
30. Vendimi Nr. 435, date 12.9.2002 “Per miratimin e normave te shkarkimeve neajer ne Republiken e Shqiperise”
31. VKM nr 352, date 29.04.2015. “Per vleresimin e cilesise se ajrit te mjedisit dhe kerkesat per disa ndotes ne lidhje me te”.

Objekt i ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, eshte percaktimi i kerkesave, pergjegjesive, rregullave dhe procedurave per vleresimin e ndikimeve te rendesishme negative mjedisore te projekteve te propozuara, private ose publike.

Sipas ligjit Per Mbrojtjen e Mjedisit, vleresimi i ndikimit ne mjedis i nje projekti te propozuar zhvillimi eshte vleresimi i ndikimeve te rendesishme, te mundshme te asaj veprimtarie ne mjedis.

Gjate procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis, kryhen identifikimi, pershkrimi dhe vleresimi ne menyren e duhur i ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie, duke percaktuar efektet e mundshme te drejtperdrejta dhe jo te drejtperdrejta mbi token, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimen, shendetin e njeriut, floren dhe faunen, peizazhin natyror, pasurite materiale, trashegimine kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre te ndersjella. Vleresimi i ndikimit ne mjedis zbaton parimin e parandalimit qe ne fazen e hershmete planifikimit te projektit, me qellim shmangien apo minimizimin e efekteve negative ne mjedis, permes harmonizimit dhe pershtatjes se saj me kapacitetin bartes te mjedisit.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjese e pergatitjeve per planifikimin e nje projekti zhvillimi dhe para kerkimit te lejeve perkatese te zhvillimit.

Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, dhe aktet nenligjore qe rrjedhin prej tij, te perafuara plotesisht me Direktiven e bashkimit Evropian per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis ka per qellim te siguroje nje nivel te larte te mbrojtjes se mjedisit, permes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit te demeve ne mjedis, nga projekte te propozuara para miratimit te tyre per zhvillim dhe garantimin e nje procesi te hapur vendimmarrjeje, gjate identifikimit, pershkrimet dhe vleresimit te ndikimeve negative ne mjedis, ne menyren dhe kohen e duhur si dhe perfshirjen e te gjitha paleve te interesuara ne te.

Ky ligj zbatohet per projektet e propozuara, private apo publike, te cilat mund te shkaktojne ndikime te rëndesishme negative, te drejtperdrejta ose jo, ne mjedis, si pasojte e madhese, natyres apo vendndodhjes se tyre.

Kerkesa te pergjithshme per vleresimin e ndikimit ne mjedis te nje projekti:

- Vleresimi i ndikimit ne mjedis perfshin percaktimin, pershkrimin dhe vleresimine ndikimeve te pritshme te drejtperdrejta e jo te drejtperdrejta mjedisore te zbatimit apo moszbatimit te projektit.
- Ndikimet mjedisore te projektit vleresohen ne lidhje me gjendjen e mjedisit ne territorin e prekur ne kohen e paraqitjes se raportit perkates per vleresimin e ndikimit ne mjedis te projektit.
- Vleresimi i ndikimit ne mjedis perfshin pergatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes se veprimtarise, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zones ne gjendjen e meparshme, nese njedetyrim i tille parashikohet me ligj. Vleresimi perfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundesine per aksidente.
- Vleresimi i projektit perfshin, gjithashtu, propozimin e masave te nevojshme per parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve te tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjate zbatimit te projektit, perfshire edhe vleresimine efekteve te pritshme te masave te propozuara.

Aspektet me te rëndesishme te procesit paraprak te VNM-se, jane konsultimet me palet e tjera dhe vendimi nese kerkohet nje VNM e thelluar.

VNM paraprak eshte faza e pare e procesit te VNM. Sipas Nenit 8 te ligjit te VNM qellimi i VNM Paraprak eshte te identifikojte propozimet qe kerkojne VNM te thelluar. VNM Paraprak perjashton nga procesi ato propozime (shumicen) qe nuk kane ndikime te rëndesishme, ose pak, ndikime lehtesisht te kontrollueshme, dhe per te cilat VNM eshte e panevojshme. Ne vijim, Tabelat dhe Listat e Kontrollit do te ndihmojne ne procesin i cili vendos nese kerkohet VNM per nje projekt te vecante ose tip projekti.

Tre fazat kryesore e VNM Paraprak jane:

- **Paraqitja e kerkeses** dhe dokumentacionit shoqerues nga zhvilluesi ne Ministrine e Mjedisit, kontrolli administrativ paraprak i aplikimit nga Ministria e Mjedisit dhe percjellja e tyre nga Ministria ne Agjencine Kombetare te Mjedisit (AKM);
- Kontrolli teknik **paraprak** i bere nga AKM dhe **konsultimi** i AKM me **insitucionet e tjera** dhe **publikimi** i aplikimit;

- AKM njofton per **vendimin e marre**, nese projekti eshte apo jo e nevojshme ti nenshtrohet procedures se thelluar te VNM, Ministrine e Mjedisit (MM) dhe palet e perfshira ne proces, dhe publikon vendimin ne faqen e internetit te AKM.

Konventat dhe marrveshjet nderkombetare ne lidhje me procesin e VNM-se

Direktiva e Këshillit të BE-së 97/11/EC e cila modifikoi Direktivën 85/337/EEC mbi Vlerësimin e Disa Projekteve Publike e Private, parashikon qe autoritetet kompetente të shteteve anëtare të kërkojnë kryerjen e një vlerësimi të ndikimit mjedisor (VNM) për projektet që mund te rezultojne me ndikim domethënës në mjedis. VNM duhet të pergatitet para miratimit të projektit, në mënyrë që vendimi për miratim të marre paraysh ndikimet e mundshme të projektit në mjedis. Direktiva paraqet një listë të projekteve që kërkojnë studimin e VNM në të tëra rastet (Shtojca 1) dhe një listë të projekteve që mund të kërkojnë një studim të permbledhur VNM (Shtojca 2), në varësi të një vlerësimi per ndikimet e mundshme qe mund te rezultojne nga projekti i propozuar apo te kriterëve kufizuese, të vendosura nga secili shtet anëtar. Propozimi aktual konsiderohet si një projekt i Shtojcës 2.

Direktiva kërkon që “VNM të identifikojë, përshkruajë e vlerësojë në mënyrën e duhur ndikimet e drejtpërdrejta e indirekte të një projekti per:

- Qëniet njerëzore, floren dhe faunen;
- Token, ujin, klimen dhe peizazhin;
- Asetet materiale te trashëgimia kulturore; dhe
- Ndërveprimin midis faktorëve të lartpërmendur.

Informacioni tjetër qe percaktohet ne direktive qe duhet te përfshihen në studimin e VNM-se jepet në Shtojcën IV të Direktivës 97/11/EC dhe ajo përfshin:

- një përshkrim të projektit;
- një përvijim të alternativave kryesore të vendodhjes dhe te teknologjise te marra ne shqyrtim per projektin e propozuar;
- një përshkrim të aspekteve të mjedisit që mund të ndikohen me shume nga projekti e që lidhen me popullsinë, florën, faunën, tokën, ujin, faktorët klimatik, asetet materiale, pejsazhin e raportin reciprok mes faktorëve të lartpërmendur;
- një përshkrim të ndikimeve domethënëse të projektit që dalin në pah nga ekzistenca e vetë projektit, shfrytëzimi i burimeve natyrore, clirimi/shkarkimi ilëndëve ndotëse, krijimi i zhurmave dhe trajtimi i mbetjeve;
- një përshkrim i masave të parashikuara për parandalimin, uljen dhe aty ku është e mundur, mënjanimin e efekteve të dëmshme në mjedis; dhe
- një përmbledhje jo-teknike e informacionit të siguruar.

Direktiva 97/11/EC (amenduar nga Direktiva 2003/35/EC pas nënshkrimit të Konventës së Aarhus nga Komuniteti, më 25 Qershor 1998, mbi pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje dhe akses në vendosjen e drejtësisë në çështjet mjedisore) gjithashtu parashikon konsultimin me publikun, në fazën e propozimit e mbledhjes së informacionit, për t'i dhënë publikut të interesuar mundësinë për të shprehur mendimin e tyre para marrjes së vendimit lidhur me zhvillimin e propozuar.

Shqipëria është anetare dhe ndjek detyrimet e konventave të mëposhtme nderkombetare:

- Konventa e Bernit (CH) “Per mbrojtjen e flores dhe faunes se eger dhe mjedisine saj natyror ne Evrope.”, miratuar me ane te ligjit nr 8690, me 2 Mars 1998;
- Konventa e Barcelones “Per mbrojtjen e mjedisit detar dhe ujqor te Mesdheut” dhe protokollet e saj;
- Konventa e Bonit “Mbi mbrojtjen e faunes se eger shtegtare”;
- Konventa e Vienes “Mbi kontrollin e kalimit kufitar te mbetjeve te rrezikshme dhe asgjesisimin e tyre”, miratuar me ane te ligjit nr. 8216, me 13 Prill 1997;
- Konventa e Vienes “Per mbrojtjen e shtreses se Ozonit” dhe protokolle i Montrealit “Mbi substancat qe demtojne shtresen e Ozonit”;
- Konventa e Aarhusit “Mbi te drejten e publikut per t’u informuar, per pjesemarrje ne vendim-marrje dhe e drejta per t’iu drejtuar organeve te drejtesise per ceshtjet mjedisore”, miratuar me ligjin nr. 8672, me 26 Tetor 2000;
- Konventa “Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis ne kuadrin Nderkombetar”. Hyr ne fuqi ne 4 Tetor 1991;
- Konventa e Kombeve te Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike, Tetor 1994;
- Konventa e Kombeve te Bashkuara mbi Biodiversitetin, Janar 1994;
- Kombet e Bashkuara “Konventa kunder zgjerimit te shkretetirave ne vendet e thata, vecanerisht ne Afrike”. Hyrja ne fuqi me 27 Prill 2000.

2. PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES KU PROPOZOHEM TE ZBATOHEM PROJEKTI

Biodiversiteti perben nje komponent shume te rendesishem te pasurive natyrore te nje vendi, hapësire apo rajoni. Me biodiversitet nenkuptohet shumellojshmeria e organizmave te gjalla ne te gjitha nivelet, duke perfshire ato tokesore, detare, ujeravete embla, si dhe komplekse ekologjike, pjese e te cileve ato jane. Ne origjine te ketij diversiteti qendrojne pozicioni gjeografik, faktore gjeologjike,

pedologjike, hidrologjike, relievi dhe klima.

- **Bimesia dhe Habitatet**

Ne pergjithesi vegjetacioni ne zonen e projektit paraqitet ne forme kullote, ku ne disa raste eshte e mbishfrytezuar. Gjithashtu ne terren vihet re nje shperndarje jouniformee bimesise se shkurter dhe pemeve. Megjithate, ne terrene te izoluara gjenden zona te vogla pyjore me vegjetacion te shendetshem. Ne zonen e projektit dominon vegjetacioni i shkurreve, ndersa nje pjese e konsiderueshme ne zone zihet nga terrenet e pjerreta shkembore. Ne kete kontekst ne zonen e projektit evidentohen pese lloje kryesore habitatesh. Keto habitate listohen si me poshte:

- Habitati tokesor natyror;
- Habitati i terreneve shkembore;
- Habitati i djerrinave dhe tokave bujqesore;
- Habitati i brigjeve te lumit te Bushtrices
- Habitati i pyjeve te perziere gjethe gjere (dominuar nga lisi)

- **Pershkrim i vegjetacionit ne secilin habitat**

Vihet re se 2/3 te llojeve te faunes qe gjenden ne Shqiperi ndodhen edhe ne arealin e Bashkise se Tiranes 133 lloje te faunes qe konsiderohet ne mbrojtje jane te kercenuara per mbijetese.

Nder rreziqet kryesore te faunes ne hapësirën e Bashkise Tirane mbeten vrasja dhe perndjekja e kafsheve, gjuetia, copezimi dhe humbja e habitatit, kullotja, zjarret, veprimtarite industriale si dhe aktivitetet te pa licensuara. Krahas ketij fakti ka shumellojshmeri faune ne Bashkine e Tiranes si shpendet ne lloje te larmishme, gjitaret, zvarraniket, amfibet dhe insektet. Pothuajse 2/3 e llojeve me status perkujdesje globale jane gjitaret, 7 prej te cileve jane lakuriq nate, banore te shpellave. Kjo evidenton rendesine e Shpelles se Zeze (Pellumbasit) si vendstrehimi kryesore i lakuriqit te nates.

Ne lidhje me floren, ne Bashkine Tirane jane identifikuar rreth 655 lloj bimesh, shifer qe perfaqeson rreth 20% te flores ne gjithë Shqiperine. Rreziku qe ekziston, ne kete rast ka te beje me moszbatimin e kriterëve teknike gjate procesit te grumbullimit te bimesive, kullotja dhe zjarret si dhe mungesa e informimit dhe sensibilizimit te komunitetit.

Lista e llojeve te rrezikuara te bimeve ne nivel kombetar eshte shume e madhe, gjithsej 319 lloje, nga te cilat jane te rrezikuara ne forme kritike 76 lloje, konsiderohen ne rrezik 123 lloje dhe te perkeqesuara 120 lloje, te cilat perballen me nje rrezik te larte ne kontekstin kombetar.

Kercenimet kryesore ndaj biodiversitetit jane: zhvillimi industrial, urbanizimi, gjuetia ilegale, peshkimi, erozioni i tokes, energjia dhe minierat, transporti dhe turizmi, sektore keto qe kane ndikim ne shumellojshmerine biologjike. Aktivitetet antropogjene ku shpyllezimi dhe shkretetirezimi i tokes se punueshme, aq sa shkaterrimi i livadheve dhe kullotave, kane pasur nje ndikim te madh ne ndryshimet e habitateve ne te kaluaren e afert. Ndertimi i rrugëve dhe ndryshimet ne rrjedhen e ujit ose ndertimi i digave, ndertimi i tubacioneve, ndotja qe vjen nga origjina te ndryshme, zjarret, semundjet dhe ndryshimet klimatike jane arsyt e degradimit dhe fragmentimit te habitateve ne Shqiperi. Mbrojtja e biodiversitetit mund te arrihet vetem duke pranuar dhe respektuar objektivat dhe parimet e ruajtjes dhe rritjes se zhvillimit te qendrueshem ne sektore qe lidhen me biodiversitetin, te tilla si bujqesia, pylltaria, peshkimi, industria, urbanizimi, transporti dhe turizmi. Shqiperia njihet per nje diversitet te larte te ekosistemeve. Brenda territorit te saj ka ekosisteme detare, bregdetare, liqenore, lumore, shkurre me

gjelberim te perhershëm dhe gjethegjere, pyje gjethegjere, pyjet me pisha, kullotat dhe livadhet alpine dhe sub-alpine, dhe ekosistemet e larta malore.

Flora e Shqiperise perfshin rreth 3250 lloje bimore, ose rreth 30% te flores Europiane (Paparisto et al. 1988). Jane 30 lloje endemike dhe rreth 180 lloje subendemike (Vangjeli et al. 1995). Eshte e rendesishme te theksohet se rreth 10% e flores shqiptare, perbehet nga speciet e rralla, speciet e rrezikuara dhe llojet relikte (Vangjeli et al. 1995). Shqiperia eshte e pasur ne burime pyjeve dhe kullotave. Pyjet mbulojne 1,040,881 ha ose 36% te territorit te vendit, dhe kullotat rreth 400,000 ha ose 15%. Perafersisht 60% (244,000 ha) e kullotave jane kullotat alpine dhe sub-alpine dhe livadhe. Pyjet dhe kullotat kane nje larmi te llojeve, formacioneve dhe komuniteteve bimore dhe shtazore. Bimet medicinale dhe aromatike (BMA) ne Shqiperi, kane kushte shume te mira fito-gjeografike per rritje dhe zhvillim ne natyre. Ato kane nje potencial te rendesishem per zhvillimin social-ekonomik, vecanerisht ne rajonet rurale. Bazuar ne te dhenat e Inventarit Kombetar te Bimeve Mjekesore dhe Aromatike te kryer ne vitin 1988, fondi i bimeve mjekesore shtrihet ne nje sipërfaqe te pergjithshme prej 1183379 ha ose 41.2% te gjithe territorit te vendit. Sipas Fondit Boteror per Natyren dhe Hartes Ekologjike Digitale te Evropes per Rajonevet nga Agjencia Evropiane e Mjedisit, territori i Shqiperise, mund te ndahet ne tri rajone ekologjike: Pyjet ilire gjetherenes, pyjet e perziera dhe pyjet e perziera Dinariko Alpine. Pyjet, sidomos ato veri veri-lindore, jane shtepi per nje game te gjere te gjitareve, duke perfshire ujkun, ariun, derrin e eger dhe dhine e eger.

Gjate viteve te fundit Shqiperia ka arritur progres dhe ka bere nje investim te madh ne mbrojtjen e ardhshme te pasurive unike natyrore dhe te peizazhit. Ne perputhje me fushat kryesore te punes te identifikuar nga 2000 NBSAP, dhe gjithashtu si rezultat i Programit Kombetar te Punes per Zonat e Mbrojtura (PKPZM) per periudhen 2006-2009, rrjeti i zonave te mbrojtur eshte zgjeruar. Qe nga viti 1996 sipërfaqja e shpallur ligjerisht si zone e mbrojtur ne Shqiperi eshte me shume se trefishuar (nga 108,475 ha ne 378,748 ha), duke e cuar perqindjen totale te zonave te mbrojtura nga 5.7 % ne vitin 2002 ne 13.17 % ne vitin 2011.

Rajoni i Tiranës dhe i Durrësit ka nje mbulesë bimore tipike te zones mesdhetare bregdetare. Ekosistemet me te rendesishme ne zonen perreth projektit jane:

- Ne brigjet e lumit Erzen
- Ne brigjet e lumit Tirana dhe Lana
- Ne brigjet e perroit te Limuthit
- **Pershkrim i faunes ne zonen e projektit**

Ne zonen e studiuar nuk ka ndonje lloj ose specie flore apo faune qe mbrohet me status te vecante. Sipas perditesimeve te Unionit nderkombetar per Ruajtjen e Natyres (IUCN), 109 lloje kafshesh te grupeve te ndryshme taksonomike jane konsideruar si te kercenuara, por persa i perket faunes se Kamzes zona paraqet specie tipike te zonave rurale. Nder rreziqet kryesore te faunes ne hapësirën e rrethit te Tiranës mbeten, gjuetia, copezimi dhe humbja e habitatit, kullotja, zjarret, veprimtarite industriale si dhe aktivitete te pa licensuara.

Nder insektet qe takohen ne zone permendim:

- i. Rendi Odonata: *Sympetrum sanguineum*
- ii. Rendi Orthoptera: *Gryllulus frontalis*, *Calliptamus italicus*, *Locusta migratoria*
- iii. Rendi Coleoptera: *Scarabaeus sacer*, *Calosoma sycophanta*, *Gyrinus notator*, *Anomala vitis*, *Oxythorea funesta*, *Cetonia aurata*, *Lampyrus noctiluca*, *Coccinella septempunctata*

iv. Rendi Lepidoptera: *Iphiclides podalirius*, *Papilio machaon*, *Aporia crataegi*, *Pieris brassicae*, *Colias crocea*, *Gonepteryx Cleopatra*, *Maniola jurtina*, *Melanargia galathea*, *Cynthia cardui*

v. Rendi Neuroptera: *Libelloides ottomanus*, *Mantis religiosa*, Herpetofauna (Amfibet dhe Reptilet)
Llojshmeria e amfibeve eshte relativisht e ulet edhe per reptilet siuate eshte pothuajse njejte, me pak lloje te pranishme. Llojet kryesore te amfibeve te pranishem ne zone jane: *Bombina variegata*, *Bufo bufo*, *Bufo viridis*, *Rana balcanica*, etc.

Llojet kryesore te gjitareve te pranishem jane: *Erinaceus concolor*, *Talpa caeca*, *Crocidura leucodon*, *Mus musculus*, *Mus spicilegu*, *Rattus norvegicus*, etj.

- Ornitofauna (Shpendet)

Pjesa me e madhe e shpendeve te hasur ne kete territorr jane dimerues dhe shtegtare, lloje qe preken me pak nga shqetesimi apo nderhyrje te tjera humane. Shpendet e perhershem dhe ata folezues te mirefillte jane dhe me te rralle. Shpendet e takuar i perkasin mjedisve te tipit te shkurretave, toka bujqesore te punuara apo te braktisura dhe qendrave te banuara. Nder ta me te zakonshem jane harabeloret me perfaqesues bilbithat e trishtilat. Ne tokat bujqesore hasen me shpesh laureshat, bishtlekundesat

- **Pershkrim i zonave te mbrojtura prane vendit ku propozohet projekti**

Ne Shqiperi, Zonat e Mbrojtura jane te konsideruara si pjese/siperfaqe e tokes dhe/ose ujit, detare/bregdetare, te destinuara kryesisht per konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore qe shoqerojne ate/ato dhe qe jane te menaxhuara ne menyre te ligjshme dhe/ose ne menyra te tjera efektive. Rrjeti i zonave te mbrojtura eshte bazuar ne kategorite e menaxhimit te IUCN dhe sistemi i ndertuar per kete qellim eshte ne perputhje me sistemin nderkombetar IUCN. Te gjashte kategorite e sistemit jane ekuivalente, te barabarta dhe te rendesishme dhe ato perfshijne te gjitha nivelet e nderhyrjes njerezore, te pranueshme per kategorine respektive. Krijimi i Zonave te Mbrojtura ka filluar qe ne vitin 1940. Ne 1981, per here te pare, asete te rralla natyrore u vendosen ne mbrojtjen shteterore duke shpallur si Monumente te Natyres pyjet me vlere shkencore, biologjike, historike dhe didaktike.

Zona ne vleresim nuk vleresohet si zone me status te vecante mjedisore apo biodiversiteti nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe nga Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura.

Sic mund te verehet edhe ne figuren e meposhtme, objekti ndodhet ne distance mbi 10 km nga kufiri i ZM "Mali i Dajtit" dhe fakti qe ndodhet ne nje zone urbane tregon se zhvillimi i projektit nuk ka asnje lloj ndikimi ne zonat e mbrojtura apo monumentet e natyres te Qarkut Tirane.




Fig. Largesia nga zonat e mbrojtura




Fig. Harta e zonave te mbrojtura ne zonen ku ndodhet objekti

3. INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE, NE SIPERFAQEN E KERKUAR NGA PROJEKTI DHE NE AFERSI TE TIJ

Ujerat siperfaqesore

Sistemi i gjere hidrologjik i Shqiperise perfshin 11 lumenj kryesore me 152 dege dheperrenj te medhenj. Lumenjte kryesor nga veriu ne jug jane:

- Lumi Drin me dy deget e tij: Drinin e Bardhe dhe Drinin e Zi;
- Lumi Mat me degen kryesore te tij: Lumin Fan;
- Lumi Ishem;
- Lumi Erzen;
- Lumi Shkumbin;
- Lumi Seman me dy deget e tij ne rrjedhen e siperme: Lumin Devoll dhe LuminOsum;
- Lumi Vjosa dhe dy deget e tij kryesore : Lumi Drinos dhe Lumi Shushica;
- Lumi Bistrica.

Zona ku ndodhet objekti ben pjese ne basenin Ishem – Erzen.

Lumi i Tiranes pershkon pjesen veriore te Tiranes, ne zonen e quajtur Bregu i Lumit aty ku formohet kufi ri administrativ verior i Tiranes i cili e ndan nga Komuna Paskuqan.

Lana derdhet ne Lumin e Tiranes, i cili kalon permes qytetit te Tiranes. Ai buron ne pjesen perendimore te Qafes se Priskes dhe ka nje gjatesi prej 29 km.

Ne hyrje te Tiranes, Lana rrjedh ne nje kanal te sistemuar betoni dhe pastaj bashkohet me lumin e Tiranes ne verilindje te Bexulles nga ku formohet Lumi i Ishmit. Lumi Ishem rrjedh permes Shqiperise Qendrore me nje gjatesi rreth 74 km i cili formohet nga bashkimi i Lumit te Tiranes, delta e te cilit ndodhet ne Kepin e Rodonit.

Megjithate, objekti ndodhet ne nje largesi te konsiderueshme nga burimet ujore (sic vihet re dhe nga harta e meposhtme, burimi: ASIG) dhe nuk ka ndikime te drejtperdrejta ne to.

Me poshte paraqitet largesia nga trupi uJOR me i afert (burimi: ASIG) dhe sic mund te vihet re distanca eshte e konsiderueshme (mbi 800 m).




Fig. Largesia nga rrjedhat ujore

Karakteristikat hidrologjike të një rajoni përcaktohen në një shkallë të madhe prej topografisë, gjeologjisë dhe kryesisht prej klimës së tij. Topografia është e rëndësishme për shkak të ndikimit të saj mbi reshjet, mbi zhvillimin e liqeneve dhe zonave kenetore dhe mbi intensitetin e rrjedhjes. Gjeologjia ndikon gjithashtu mbi topografinë dhe gjithashtu jep informacion mbi zonën e ujërave nentokesore ku uji leviz ngadale mbi akuiferin drejt lumit apo detit. Klima e një zone, që shpjegon kushtet e motit në këto zone si mesatare gjatë një periudhe të gjatë kohe, varet nga pozicioni gjeografik i saj në sipërfaqen e tokës. Rëndësia e këtyre qëndron në faktin që ato ndikojnë drejtpërdrejt mbi perseritjen dhe ndryshueshmërisë së reshjeve, avullimit dhe transpirimit.

Territori Bashkisë së Tiranës përkrohet nga tre lumenj: lumi i Tiranës, Lanes dhe i Terkuzes. Të tre këta rrjedhin poshtë nga ana jug-lindore në drejtimin veri-perëndimor përmes lugines së Tiranës. Lumi i Tiranës dhe lumi i Lanes përkrijnë pjesën qendrore të lugines së Tiranës, ndërsa lumi i Terkuzes rrjedh poshtë në periferi të lugines, drejt veriperëndimit.

Keta lumenj janë pjesë e pellgut ujëmbledhës të lumit Ishem. Lumi-Ishem përkrijnë gjithë luginen me deget e tij: Lana, Tirana, Terkuza të cilët në fshatin Larushk formojnë Lumin-Gjola. Me tej, Lumi Zeza së bashku me Lumin Gjola në fshatin Bilaj formojnë Lumin Ishem. Delta e Lumit Ishem ndodhet në Kepin e Rodonit. Prurja mesatare vjetore e Ishemit është $20.9 \text{ m}^3/\text{sek}$ me modul mesatar të rrjedhies 31.01 l/sek/km^2 ndërsa prurja maksimale është $1980 \text{ m}^3/\text{sek}$. Në sipërfaqen më të madhe shtresa ujëmbajtëse mbulohet nga një shtresë argjilore. Mbulesa suargjilore mbi shtresën e zhavorreve fillon nga 0 deri disa metra m në afërsi të shtratit të lumenjve (Lana, Tirana, Terkuza, Zeza, Droja) deri në 40-50 m. (Vako, 2014).

Prurjet e ketyre lumenjve kane luhajte te medha; lumi i Tiranes varion nga 0.3 - 300 m³/sek; Lumi i Lanes nga 0.1-30 m³ / Sek dhe Lumi i Terkuzes nga 0.5-400 m³ / Sek ose me shume. Ne pjesen e siperme te lumit te Terkuzes eshte ndertuar nje dige dhe prej ketij ujembledhesi furnizohet kryesisht qyteti i Tiranes. Regjimi i natyrshem i lumit te Terkuzes aktualisht ka pesuar ndryshime rrenjesore, per shkak te nderhyrjeve me qellim marrjen e inerteve. Ujerat siperfaqesore dhe nentokesore mund te perdoret si uje i pijshem per vlerat e tyre natyrore, por ne te njejten kohe ato jane te kercenuara nga ndotja urbane. Mbetet konstant kercenimi nga permbytjet, ne momente prurish te medha. Ne vitet e fundit ka patur deme te konsiderueshme ne objektet e banimit per shkak te permbytjeve. Pervec investimeve me natyre parandaluese, nevojitet edhe koordinimi i ngushte i punes me Bashkine e Tiranes.

Liqeni i Paskuqanit eshte nje prej resurseve me te rendesishme ujore te Bashkise se Kamzes. Ai ze nje siperfaqje prej 170 ha dhe aktualisht zona perreth liqenit eshte zene nga banesa informale te ndertuara pas viteve '90, por numri i tyre eshte i pakot. Ky liqen mund te marre nje rendesi te vecante, pasi ne drejtim te tij shkon zgjatimi i bulevardit qendror te kryeqytetit dhe egziston nje projekt mjaft ambicioz per ta shnderruar zonen perreth liqenit ne nje park te madh, te gjelber me karakter pushues e argetues. Siperfaqja e ujembledhesit eshte zvogluar si rezultat i renies se sasise se prurjeve, ndertimet informale si dhe humbjes se funksionalitetit per te cilin eshte ndertuar. Pasqyra ujore eshte variable dhe eshte ne korelacion me sasine e rreshjeve, dhe mos funksionit te kanalit te furnizimit te tij me uje. Aktualisht, ky rezervuar eshte kthyer ne nje pellg ujembledhes ku pothuajse gjate gjith vitit qendron ne kuoten "niveli i vellimit te vdekur". E gjithe siperfaqja e tokes bujqesore prej 3000 ha (kapaciteti i projektuar i aftesise ujites), qe ky rezervuar fuste nen regjimin ujqor eshte transformuar ne siperfaqe/territore te urbanizuara.

Territori i bashkise Tirane ka pesuar transformimin/urbanizimin me te theksuar ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Ne lidhje me standartet mjedisore te parametrave te ujit, nuk ka monitorime por jane evidentuar problematika te medha, si rezultat i derdhjes ne te te ujerave te zeza, mbetjeve inerte, plastikes etj.

- *Lumi Lana*

Lugina e Lumit Lana e ka zanafillen e vet ne perendim te vargut malor Kruje-Dajt. Ai buron nga pjesa perendimore e Qafes se Priskes, eshte 29 km i gjate, siperfaqja e pellgut te tij eshte 67 km², lartesia e tij mesatare tij eshte 179 m dhe pjerresi 24 m/km. Ai kalon permes qytetit te Tiranes ne nje kanal te sistemuar betoni dhe pastaj bashkohet me Lumin e Tiranes ne fshatin Laknas. Prurjet e tij luhaten nga 0.06-0.7m³/sek minimale dhe nga 0.208-1.82 m³/sek ato maksimale gjate dimrit. Prurja maksimale shumevjecare e tij eshte 0.69 m³/sek ne muajin janar dhe ajo minimale eshte 0.26 m³/sek ne muajin gusht. Ndersa prurja mesatare shumevjecare ne Stacionin Lana. Hotel-Dajti per vitet 1956-1990 eshte 0.49 m³/sek. (Vako, 2014)

- *Lumi Tirana*

Fillon ne pjesen verilindore te qytetit te Tiranes ne Shupal, duke marre formen e plote ne fshatin Ferras mbi uzinen e Artilerise. Duke zbritur ne drejtim te Babrruse formon dhe ushqen zhavorret aluviale deri ne Koder-Kamez ku se bashku me Lumin Lana vazhdon formimin e shtreses ujembajtese me uje. Ne

pergjithesi ky lume eshte i ndotur sidomos ne periudhen e thate te vitit. Prurja mesatare shumevjecare e tij eshte 2.47 m³/sek. (Vako, 2014)

- *Lumi Terkuza*

Pershkon zonen jug-lindore te zones dhe eshte nje dege e lumit Gjola. Ne zonen malore, gjeresia e shtratit te tij arrin 100-300 m, lartesia e brigjeve te tij arrin 80- 100 m. Kur del ne depresionin Tirane-Ishem ky lume zgjeron shtratin e tij ne 300-400 m. Duke filluar nga fshati Zall-Herr kalon direkt mbi zhavorret zallishtore ne nje gjatesi prej gati 10 km deri ne Rinas dhe eshte formuesi i zones ujembajtese Zall-Herr-Kamez- Laknas si dhe ushqyesi kryesor i tyre me ujra nentokesore. Prurjet e tij minimale jane rreth 0.3-0.5 m³/sek ne periudhen e veres, ndersa ne periudha me reshje te dendura prurja shkon deri ne disa qindar m³/sek. Prurja mesatare shumevjecare ne Stacionin Zall-Herr eshte 3.37 m³/sek (Buletini Hidrometeorologjik, 1975-1992). Uji i tij eshte relativisht i ndotur ne pjesen e poshtme te tij. (Vako, 2014).

Gjithsesi, ne vija te pergjithshme, Shqiperia zoteron burime te bollshme te ujit. Edhe pse sasite jane te mjaftueshme per nevojat aktuale, cilesia e tyre shpesh eshte problem per shkak te ndotjes se tanishme dhe historike, sidomos ne zonat e uleta fushore ku jeton pjesa me e madhe e popullsisë dhe ku zhvillohen pjesa me e madhe e aktiviteve industriale dhe bujqesore. Problem tjetër mbetet shperndarja jo e njetrajtshme e burimeve ujore ne vend. Burimet e pergjithshme, te ripertertishme, te ujit ne Shqiperi perdoren per qellime urbane, industriale dhe bujqesore si edhe per sigurimin e prodhimit te energjise elektrike nga hidrocentralet.

Ujrat siperfaqesore dhe ato nentokesore jane te lidhur dhe varen nga njeri tjetri, por konsiderohen burime te ndara. Shqiperia ka gjashte lumenj te medhenj, ka liqene te medha nderkufitare dhe te lundrueshme, si dhe formacione te rendesishme ujembajtese, megjithate burimet ujore jane te shperndara ne menyre jo te barabarte ne vend. Ne vend ka hidrocentrale dhe rezervuare vaditjeje si dhe nje numer lagunash dhe mocallesh me vlere. Shqiperia renditet midis vendeve qe kane potenciale te medha me uje, baras me 8600 m³ per fryme ne vit.

Derdhja mesatare vjetore e ujit ne det eshte 40,5 bilion m³, e cila korrespondon me nje derdhje prej 1300m³/sek. Reshjet jane nje burim i rendesishem i ujit me nje mesatare aktuale vjetore prej 1485 mm/vit. Burimet e ujerave siperfaqesor perdoren per prodhimin e energjise (hidro-energji), industri dhe vaditje ku formacionet ujembajtese jane shume produktive dhe furnizojne me uje te pijshem shumicen e popullsisë urbane.

Uji perdoret ne te gjitha aspektet e jetes dhe eshte i rendesishem per perdoruesit publik dhe industriale. Si rrjedhoje e sistemeve te papershtatshme te monitorimit, ndryshimet e shpejta ne aktivitetet ekonomike dhe popullsi eshte e veshtire te vleresohet perdorimi i ujit ne terma te sakte.

| Perdorimi i Ujit | Volumi(bilion m³) |
|-------------------------|-------------------------------------|
| Hidrocentrale | 14,0 |
| Vaditje | 1,013 |

| | |
|-------------------|--------|
| 626 rezervuare | 0,560 |
| Lumenj dhe Liqene | 0,450 |
| Uje Nentokesor | 0,003 |
| Uje i pijshem | 0,22 |
| Totali | 16,246 |

Tabela. Vleresim i perafert i perdorimit te ujit ne Shqiperi




Fig. Harte Baze e Baseneve Ujore ne Shqiperi

- Pershkrimi i Mjedisit

Pershkrim i faktoreve klimatike

Duke iu referuar ndarjes klimatike te Shqiperise kjo zone ben pjese ne nenzonen mesdhetare fushore qendrore dhe ne nenzonen mesdhetare kodrinore qendrore (Vako, 2014). Sipas percaktimit qe behet ne Harten e Zonave Klimatike te Shqiperise te perpiluar nga Instituti Hidrometeorologjik, i gjithe territori i bashkise se Kamzes ka nje klime tipike mesdhetare, me dimer te bute dhe vere te nxehte. Karakteristike per stinen e dimrit jane shirat, te cilet ne mjaft raste jane te dendura. Ne shumicen e vendit nje pjese e reshjeve ndodh edhe gjate vjeshtes se vonë dhe ne prag te pranveres. Nje tipar i dallueshem i klimes se ketij territori eshte se aty perfshihen pothuajse te gjitha llojet e klimave te Shqiperise, nga ajo mesdhetare fushore, deri tek ajo mesdhetare malore. Temperaturat mesatare vjetore luhaten nga 5,8 0 C ne 15,10 C. Temperaturat maksimale absolute kane arritur ne 41,5 ndersa ato minimale absolute ne -10,50.

Zona ku ndodhet objekti perfshihet ne zonen klimatike mesdhetare fushore te Shqiperise. Kjo zone karakterizohet nga dimer te bute dhe te laget dhe vere te nxehte dhe te thate. Vendmatjet kryesore te vecorive klimatike jane ne Tirane, Kamez dhe Sukthi.




Fig. Harta e Zonave Klimatike te Shqiperise

- **Rrezatimi diellor**

Rrezatimi diellor eshte burimi kryesor i energjise, percakton motin dhe klimen. Transmetimi i energjise drejt tokes ndodh nepermjet rrezatimit, percjellshmerise dhe konveksionit. Rrezatimi diellor i kesaj zone eshte studiuar nepermjet te dhenave te stacionit te Kamzes sipas te dhenave meteorologjike te IGJEU. Nga te dhenat rezulton se sasia vjetore e rrezatimit te pergjithshem diellor arrin vleren 1484.8 keh/m², vlera me e larte e tij arrihet ne muajin korrik (211.6 kwh/m²) dhe ajo me e ulet ne muajin

dhjetor (49.2 kwh/m²). (Vako, 2014). Persa i perket zgjatjes se diellezimit, ashtu si edhe ne rastin e rrezatimit diellor, karakterizohet nga nje numer i madh i oreve me diell. Mesatarisht gjate vitit ka 2431.4 ore me diell me vleren me te larte ne muajin korrik me 328.0 ore dhe ate me te ulet ne muajin dhjetor me 117.7 ore.

Kjo zone me karakterin e theksuar luginor, me drejtim dominues Veriperendim-Juglindje i nenshtrohet dukshem ndikimit te Detit Adriatik. Ne vlerat e ketij treguesi rol te rendesishem luan pozicioni topografik, te hapur ne drejtim te perendimit, si dhe konfiguracioni i relievit. Per kete arsye ne studimin klimatik jane pare vlerat e stacioneve te Tiranës dhe Durresit. Zgjatja faktike e diellzimit ne mesatare vjetore eshte 2617ore, per janarin 125 ore, korrikun 350 ore. Zgjatja relative e diellzimit eshte per janarin (45%), korrikun (80%) dhe vjetore 60%. (Referuar Atlasit Klimatik te R.Shqiperise 1988). Nga te dhenat rezulton se mesatarja ditore e rrezatimit te pergjithshem diellor arrin vleren ne korrik 6781 Kwh/m² per Tiranen dhe 6802 Kwh/m² per Durresin.

| Muaji | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor |
|--------|-------|--------|------|-------|------|---------|--------|-------|---------|-------|--------|---------|
| Tirane | 1830 | 2468 | 3346 | 4468 | 5602 | 6477 | 6781 | 5990 | 4619 | 3229 | 1981 | 1546 |
| Durres | 1840 | 2559 | 3504 | 4693 | 5730 | 6557 | 6802 | 6029 | 4631 | 3190 | 2018 | 1567 |

Tabela. Shperndarja sasiore e oreve me diell

- **Reshjet**

Rreshjet mesatare vjetore jane 1219 mm/vit dhe sasia mesatare e reshjeve eshte 931.1 mm/vit. Ne kete zone kjo shperndarje eshte e pabarabarte ne periudha te ndryshme te vitit. Sasia me e madhe e reshjeve bie gjate gjysmes se ftohte te vitit rreth 70%, nderkohe qe gjate muajve te veres sasia e tyre eshte me e vogel, rreth 30%. Sasite vjetore shume vjecare pasqyrohen ne tabele te marra nga te dhenat meteorologjike te IGJEUM per dy stacione qe pasqyrojne me teper bashkine ne studim. Sic shihet nga grafiku sasite me te vogla te rreshjeve verehen ne muajin Korrik perkatesisht me 37.9 mm ne stacionin Larushk dhe sasite me te medha i perkasin muajit Nentor po ne ate stacion perkatesisht me vleren 178.3 mm.

| Muajt | | 01 | 02 | 03 | 04 | 05 | 06 | 07 | 08 | 09 | 10 | 11 | 12 | Vjetor |
|--------------------------|--------|------|------|------|------|-----|-----|-----|------|------|-------|-------|------|--------|
| Reshjet | | | | | | | | | | | | | | |
| Reshjet mujore mm | | 112 | 98 | 86 | 60 | 57 | 28 | 12 | 20 | 35 | 131 | 164 | 150 | 983 |
| Max 24 oresh mm | | 89 | 83.6 | 63 | 66.1 | 67 | 77 | 35 | 65.3 | 72.3 | 182.5 | 180.8 | 59 | 1042.6 |
| Numri i diteve me reshje | 0.1 mm | 13.3 | 11.5 | 10.7 | 8.8 | 7.5 | 4.9 | 3.5 | 3.5 | 5.7 | 10.7 | 12.4 | 14.4 | 106.9 |
| | 5 mm | 6.1 | 5.5 | 5.1 | 3.5 | 3.3 | 1.8 | 1.0 | 1.5 | 2.5 | 5.4 | 8.5 | 7.2 | 51.4 |
| | 10 mm | 4.2 | 3.3 | 2.7 | 1.9 | 1.9 | 0.9 | 0.5 | 0.9 | 1.6 | 3.6 | 5.5 | 4.1 | 31.1 |

Tabela. Sasia e rreshjeve te rena gjate nje viti

- **Temperatura**

Ne rajonin e Tiranes dhe Durresit, temperatura e ujit eshte me e larte ne muajet e veres (Korrik – Gusht), ku edhe sasia e energjise diellore eshte me e madhe, ndersa temperature me e ulet eshte ne dimer, ne muajin Shkurt. Persa i perket vecorive sezonale mund te pohojme qe gjysma e ngrohite e vitit prill-shtator karakterizohet nga temperature mesatare 20.6°C ndersa gjysma e ftohte 12.4 °C. Ecuria vjetore e temperaturave maksimale absolute te ajrit eshte e njejte me ate te temperaturave mesatare, pra me nje minimum ne janar dhe maksimum ne Korrik ose Gusht.

Temperaturat maksimale absolute >30°C fillojne te regjistrohen qe nga muaji Maj dhe vazhdojne deri ne Shtator. Temperatura maksimale absolute me e larte e vrojtuar eshte 39.0°C ne Korrik (viti 2007).

Nje nga treguesit me te rendesishem per te karakterizuar temperaturat maksimale te ajrit eshte dhe mesatarja maksimale, vlerat e se ciles variojne nga 12°C ne Janar deri ne 27.8°C ne Korrik.

Minimumi absolut i tyre arrihet ne muajin Janar (-6.0°C). Por duhet permendur gjithashtu duke vlera te ulta te ketij treguesi jane vrojtuar qysh ne Nentor (-1.6°C) deri ne muajin Mars (-5.2 °C). Lageshtia e ajrit gjate vitit luhetet ne kufirin nga 73% deri ne 79%, ndersa vlera mesatare vjetore e lageshtires eshte 76%.




Fig. Temperaturat me te larta dhe me te uleta ditore per Tiranen

- **Era**

Ndikimi i detit Adriatik ne rajonin Tirane-Durres eshte I dukshem sidomos per sa i perket shpejtesise se eres dhe rregjimit te saj karakteristik gjate stines se veres. Ererat jane nje element mjaft I rendesishem per gjeografine dhe agro-metereologjine e rajonit. Kjo lidhet jo vetem me qarkullimin e pergjithshem

te atmosferes por dhe me relievin dhe afersine e detit. Era ka karakterin e puhizes detare vecanerisht gjate sezonit te nxehte, dmth gjate dites era fryn nga deti ne toke, ndersa gjate nates nga toka ne drejtim te kundert. Drejtimi mbizoterues I eres ndryshon sipas stineve. Gjate periudhes se veres era dominuese fryn nga kuadranti I perendimit, nersa gjate periudhes se dimrit era fryn nga kuadranti I lindjes.

Intensiteti i eres sipas drejtimeve

| Nr . | Elementet | Nr. Era | Drejtimi i eres | | | | | | | |
|------|-------------------------------------|---------|-----------------|-----|-----|------|-----|-----|------|-----|
| | | | V | VL | L | JL | J | JP | P | VP |
| 1. | Shperndarja vjetore e drejtimit (%) | 11.9 | 27.5 | 2.9 | 4.3 | 16.7 | 8.2 | 4.7 | 12.5 | 8.1 |
| 2. | Shpejtesia mesatare(m/s) | _ | 3.3 | 2.4 | 3.5 | 4.5 | 6.7 | 5.8 | 4.9 | 4.4 |

- **Pershkrim gjeomorfologjik dhe sizmiciteti i zones se projektit**

Gjeomorfologjia

Perdorimi i tokes

Tokat bujqesore ne rajonin e zones ne studim, kane pesuar transformime te konsiderueshme ne harkun kohor te tridhjte viteve te fundit, si pasoje e aktivitetit njerezor. Demtimi i zinxhirit te prodhimit bujqesor ne rajon ka prekur te gjithë elementet perberes se tij duke ndervepruar direkt mbi mjedisin ne teresi si dhe mbi jeten njerezore. Politikat territoriale te deritanishme nuk munden te ruanin nje zhvillim te qendrueshem ne Sistemin e Urbanizimit Urban – Rural si pasoje e kerkeses per zhvillim ne hapsira sherbimi dhe banimi, formale dhe informale. Sistemi i vaditjes se tokave bujqesore dhe sistemi i rezervuareve te rajonit si dhe nderlidhja e tyre me rrjetin e burimeve ujore jane demtuar rende nga mungesa e mirembajtjes si dhe nga demtimet njerezore. Sistemi i magazinimit, perpunimit dhe nderlidhjes se tregjeve rajonale eshte inekzistent si pasoje e zhvillimit te pakontrolluar dhe ndryshimit te destinacionit te perdorimit te godinave pas privatizimit te tyre ne vitet 1990. Siperfaqet e tokave bujqesore ne rajon u demtuan rende nga ndertimet formale dhe informale, duke ndryshuar eficencen e tyre ne shfrytezim dhe perdorim si dhe duke ndryshuar statusin e perdorimit te tokes.

Demtimi i zinxhirit te prodhimit bujqesor ne rajon ka prekur te gjithë elementet perberes se tij duke ndervepruar direkt mbi mjedisin ne teresi si dhe mbi jeten njerezore.

Politikat territoriale te deritanishme nuk munden te ruanin nje zhvillim te qendrueshem ne Sistemin e Urbanizimit Urban – Rural, si pasoje e kerkeses per zhvillim ne hapsira sherbimi dhe banimi, formale dhe informale. Sistemi i vaditjes se tokave bujqesore dhe sistemi i rezervuareve te rajonit si dhe nderlidhja e tyre me rrjetin e burimeve ujore jane demtuar rende nga mungesa e mirembajtjes si dhe nga demtimet njerezore. Sistemi i magazinimit perpunimit dhe nderlidhjes se tregjeve rajonale eshte inekzistent si pasoj e zhvillimit te pakontrolluar dhe ndryshimit te destinacionit te perdorimit te godinave pas privatizimit te tyre ne vitet 1990.

Siperfaqet e tokave bujqesore ne rajon u demtuan rende nga ndertimet formale dhe informale, duke

ndryshuar efencen e tyre ne shfrytezim dhe perdorim si dhe duke ndryshuar statusin e perdorimit te tokes.




Fig. Harta e perdorimit te tokes

(toka bujqesore, zona te populluara para 1990, zona te populluara pas 1990)

Rajoni ka nje numer te konsiderueshem tokash bujqesore te cilat jane me produktivitet te larte por me efence perdorimi te ulet.

Dallohen tipet:

Toka te erreta gri dhe gri-kafe.

Karakteristika kryesore e ketyre tokave eshte aftesia e tyre per te grumbulluar uje, sidomos ne periudhen e ngrohte te vitit, ku infiltrimi poshte ne shtresat argjilore te tokes eshte i lehte. Keshtu, kjo rrit rrjedhjen e ujit te rrjetit nentokesor. Ne dimer dhe pranvere, per shkak te niveleve te larta te lageshtis, keto toka jane me pak te depertueshem, keshtu qe ato kane nje ndikim me te madh ne te ushqyerit e siperfaqes se rrjetit hidrografik.

Tokat-gri te erret, te cilat jane formuar mbi shtresat argjilore nen livadhet malore kane nje koeficient te ulet infiltrimit edhe gjate rrebesheve. Gjate periudhes se nxehte te vitit, perrenjte qe derdhet mbi keto toka jane te thata. Shtresa ngjyre kafe dhe gri-kafe te tokes shtrihen nen zonat grikafe. Ne pergjithesi, ato jane te formimit te njejte dhe shtrihen ne te njejten thellesi si zonat ujembledhese ngjitur. Ne zonen bregdetare ka toke aluviale kripur. Brigjet e lumit jane formuar ne shtresa. Tokat jane ranore dhe argjilore

(me rere lumi). Tokat ndikojne keq ne rrjedhen lumore, per shkak te aftesise se gjireve lumor dhe pjerresis se vogel.

Tokat livadhore te hinjta kafe.

Tokat kane profil te diferencuar, ngjyre qe ndryshon nga e hinjte e erret, ne siperfaqe ne te hinjte te zverdhur ne thellesi. Ato jane formuar ne formacione deluviale, aluvio-deluviale dhe aluvionale te vjetra, nen mbulesen e bimesise barishtore te livadheve si, terfili, jonxha e eger, luleshqera, zhabina, krisja, grami, etj. Meqenese keto toka formohen ne nje relief te perbere kryesisht nga fusha, kerkojne nje kujdes te vecante, sidomos gjate periudhes se lagesht te vitit, pasi jane te ngopura me uje. Gjate kesaj periudhe te vitit niveli i ujerave freatike, shkon nga 60-12-cm. Nje dukuri e tille, ne tokat me drenazh natyror te dobet, ose pa sistem kullimi artificial, sidomos ne ato me strukture te pazhvilluara e te ngjeshura, prish raportin uje-ajer, pengon aktivitetin mikrobiologjik, dhe per pasoje ndikon per keq ne regjimin ushqyes te vete tokes. Prandaj kullimi i tokave ne kete periudhe eshte nje mase e domosdoshme. Nga perberja mekanike keto toka jane me teper subargjilore, te renda dhe deri diku te mesme. Nga shkalla e pjellorise ato jane te varfera ose mesatare ne humus, azot, te pasura ne potas, kurse ne fosfor jane te varfera.

Fig. Harta e tipologjive te tokes

Ne territorin e bashkise se Tiranes, dalin ne siperfaqe shkembinj te moshave mesozoike dhe kenozoike. Keta shkembinj kane vecorite e tyre sipas zones gjeotektonike se ciles i perkasin. Pershkrimi gjeologjik bazohet ne Harten Gjeologjike shk. 1:100 000, botimi i vitit 2014, si dhe ne shume studime te kryera nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar. Bazuar ne harte dhe zonen tektonike te bashkise dallohen dy zona qe perfaqesohen nga depozitime te miocenit te siperm me dhera ranore, argjila, dhe depozitime te Pleistocen-Holocenit qe paraqiten ne formen e rerave, zhavore, alevrite. Nga pikepamja gjeologjike, territori i Bashkise Tirane eshte ndertuar mbi formacione te Depresionit Prane-Adriatik (D.P.A) dhe te Kuaternarit.

Formacionet e Depresionit Prane-Adriatik (D.P.A) jane depozitime mollasike dhe pergjithesisht shtrihen transgresivisht mbi formacionet e poshteshtruara te zones Jonike dhe zones se Krujes. Depozitimet mollasike ndertojne pjesen perendimore e qendrore te territorit te qarkut te Tiranes. Depozitimet mollasike te Serravalianit dhe Miocenit te Siperm te pandare (N1³) jane pershkruar me vete. (E. Bedini, N. Vuckzaj, 2014).

- *Serravaliani (N1²s)*

Depozitimet e Serravalianit (N1²s) perhapen ne pjesen qendrore e veriore te zones ne studim. Depozitimet e Serravalianit te Depresionit Prane-Adriatik perbehen nga argjila, gelqerore litotamnik dhe alevrolite me thjerrza ranore. Trashesia eshte 2500-3300 m. Depozitimet e Serravalianit takohen edhe ne depresionin e Tiranes. Ato shtrihen ne pjesen juglindore te sinklinalit te Tiranes. Ne krahun perendimor Serravaliani shtrihet pa tregues te qarte te transgresionit, mbi formacionin shliror te Langianit, ndersa ne krahun lindor ai shtrihet transgresivisht mbi Burdigalianin. Me ne veri depozitimet e Serravalianit shtrihen transgresivisht dhe me diskordance te theksuar kendore mbi formacionet e zones se Krujes. Depozitimet e Serravalianit perbehen nga alevrolite, argjila, konglomerate, ranore, gelqerore ranorike, gelqerore

litotamnisk, etj. Trashesia është rreth 1300 m.

- *Mioceni i Siperme (NI³)*

Konsiderohet se një ndarje e qarte e Tortonianit dhe Mesinianit në depresionin e Tiranës, nuk është e

mundur për shkak të mungesës së faunës së pershtatshme. Kështu megjithatë në sinklinalin e Tiranës ka prerje në disa lokalitete ku depozitimet e Tortonianit mund të dallohen saktë nga ato të Mesinianit. Mioceni i Siperme në harta të shkalleve të vogla të paraqitet i pandarë.

Në depresionin e Tiranës, depozitimet e Miocenit të Siperme përhapen nga miniera e Krrabes dhe vazhdojnë në veriperendim nga Mushqetaja deri në Manez dhe në lindje në Skuterre-Priske e Burizane, duke ndertuar të dy krahët e depresionit. Në depresionin e Tiranës vecohen katër formacione të depozitimeve të Miocenit të Siperme: (1) Formacioni Priska. Pjesa e poshtme e prerjes përbehet nga ranore shtrese trashederi masive. Në pjesën e siperme shfaqen gelqeroret litotamnisk. Trashesia është 150-400 m. (2) Formacioni Skuterra. Perfaqësohet nga nderthurje paketash të trasha argjiloro-alevrolitike. Trashesia është 300-380 m. (3) Formacioni Iba. Perfaqësohet nga ranore shtrese trashë deri masive. Trashesia është 180-460 m. (4) Formacioni Mezezi. Perfaqësohet nga ranore, alevrolite e argjila. Trashesia është 450-670 m. Në pjesën juglindore të depresionit të Tiranës, depozitimet e Miocenit të Siperme, vendosen transgresivisht mbi depozitimet e Serravalianit e ato me të vjetra. Në krahun lindor të depresionit, megjithatë gjatë gjithë kontaktit me gelqeroret e strukturës së Dajtit kanë marrëdhënie tektonike, fillimisht ato kanë qenë transgresive. Trashesia e depozitimeve të Miocenit të Siperme varjon nga 700 m në Zall-Herr, në 1400 m në prerjen e Krrabes.

- *Tortoniani (NI³ t)*

Depozitimet e Tortonianit përgjithësisht vijojnë normalisht mbi ato të Serravalianit. Në territorin e qarkut të Tiranës, përveç depozitimeve të depresionit të Tiranës të cilat janë përfshirë në Miocenin e Siperme të pandarë, depozitimet e Tortonianit takohen në Peze e Madhe, sinklinalin e Vrapit etj. Depozitimet e Tortonianit përgjithësisht mund të ndahen në dy pako: (a) ranore me ndershtresa të trasha argjilore dhe alevrolitore. Trashesia 500-700 m. (b) ranore shtrese trashë. Trashesia 250-500 m.

- *Mesiniani (NI³ m)*

Depozitimet e Mesinianit vijojnë stratigrafikisht mbi ato të Tortonianit dhe përhapen gjerësisht në antiklinalin e Kavajës, monoklinalin e Thartorit, etj. Përgjithësisht vecohen katër pako që nga poshtelart janë: (a) Pako ranoro-argjilore me ndershtresa gelqerorësh litotamnisk. Trashesia është rreth 250 m. (b) Pako ranoro-argjilore. Trashesia është deri 800 m. (c) Me siper vendoset një pako argjiloro-alevrolite. Trashesia 150-600 m. (d) Në pjesën e siperme të prerjes takohet pakojë e argjilave gipsmbajtëse. Trashesia është rreth 500 m.

- *Plioceni (N2)*

Përhapet kryesisht në pjesën perëndimore të qarkut të Tiranës, në Rrogozhinë-Kavajë, Kryevidh. Depozitimet e Pliocenit ndahen në dy formacione kryesore: Helmasi (N2 1H) dhe Rrogozhina. Formacioni Helmasi (N2 1H) përbehet nga tre pako litologjike që nga poshtelart janë: a) Pako ranorokonglomeratike. Trashesia është 350-600 m. b) Pako argjiloro-alevrolite. Trashesia është 600-1000 m. c) Pako argjiloro-alevrolitike. Trashesia është 230-700 m.

- *Kuaternari (Q)*

Depozitimet e Kuaternarit kane perhapje te gjere ne territorin e qarkut te Tiranes. Ato perhapen gjerisht ne fushen e Tiranes, ne fushen e Kavajes, ne segmentin Spille-Lumi Shkumbin, ne luginen e lumit Erzen etj. Ne depozitimet Kuaternare vecohen ato te Pleistocenit dhe te Holocenit. Ato kane gjeneze aluviale, detare, lagunore, kenetore, proluviale, koluviale, deluviale.

Ne fushen e Kavajes depozitimet kuaternare kane trashesi te konsiderueshme dhe zene nje siperfaqe te madhe. Depozitimet aluviale Holocenit te Hershem (Qh1) perbehen nga argjila, alevrite, rera, zhavorre dhe kane nje trashesi deri 90 m.

Ne kete rajon depozitimet e Holocenit te Vonshem (Qh2) jane aluvionale (rera, zhure, argjila, me trashesi rreth 5 m), lakustrine (rera, argjila, alevrite, me trashesi rreth 15 m), kenetore (torfa, argjila, alevrite, me trashesi rreth 15 m). Takohen gjithashtu depozitime detare dhe eoliane (rera, duna) me trashesi rreth 5 m. Ne fushen e Tiranes depozitimet e kuaternarit shpesh i kalojne 100 m trashesi. Vecohen depozitimet e Pleistocenit te Vonshem dhe te Holocenit. Depozitimet e Pleistocenit me trashesi 25-40 m perfaqesohen nga koluvione, deluvione, aluvione etj. Keto depozitime perbehen nga argjila, alevrite, rera, zhavorre. Depozitimet aluvionale te Holocenit te Hershem (Qh1) kane trashesi deri ne 90 m. Ato perbehen nga argjila, alevrite, rera, zhavorre. Depozitimet e Holocenit te Vonshem (Qh2) jane kenetore (torfa, argjila, alevrite, me trashesi rreth 15 m), lakustrine (rera, argjila, alevrite, me trashesi rreth 15 m), aluvionale (rera, zhure, argjila me trashesi rreth 5 m). (E. Bedini, N. Vuckzaj, 2014)

- *Hidrogjeologjia*

Resurset ujore nentokesore lidhen me porozitetin, carjet, shkallen e karstezimit te formacioneve gjeologjike. Harta Hidrogjeologjike eshte nje paraqitje e kushteve hidrogjeologjike. Ajo paraqet gjith informacionin hidrogjeologjik te deritanishem lidhur me resuset ujore dhe perben nje dokument shume te rendesishem per menaxhimin e integruar te resuseve ujore nentokesore. Resurset me te rendesishme te ujerave nentokesore lidhen me porozitetin nderkokrrizor te depozitimeve zhavorore dhe me porozitetin carje-karst te gelqeroreve.

Akuifere me porozitet nderkokrrizor te shkrifet me ujepercjellshmeri shume te larte-te larte.

Akuifer me porozitet nderkokrrizor te shkrifet me ujepercjellshmeri shume te larte-te larte eshte klasifikuar akuiferi i bashkise Tirane, qe lidhet me depozitimet Kuaternare aluviale. Akuiferi ka perhapje te gjere, perfaqeson nje depresion te mbushur me depozitime Kuaternare, kryesisht zhavorror, pruduk i materialit te ngurte aluvial qe kane sjelle lumenjte Terkuza, Tirana e Lana. Ky akuifer ne lindje dhe perendim rrethohet nga shkembinjte kompakt kryesisht nga ranoret dhe argjilat alevrolitike te Tortonianit. Zhavorret formojne ne pergjithesi nje shtrese te vetme ujembajttese, qe ne disa sektore te vecante ne veri-perendim ka 2 e me shume ndershtresa- horizonte ujembajttese. (N Puca, A. Pambuku, R. Lika, M. Bele, 2014)

Akuiferi ujembajtes i Tiranes perfaqeson ne vetvete zonen e ushqimit te akuiferit te madh ujembajtes te Tirane-Ishmit. Ne kete akuifer horizonti kryesor ujembajtes perfaqesohet nga depozitimet e zhavorreve Kuaternare. Keto depozitime kane perhapje ne gjithë zonen ku shtrihet qyteti i Tiranes,

Selite, Kombinat-Yzberisht, Mezez, Laknas, Valias, Rinas, Gjec-Fushe dhe vazhdojne drejt zones Fushe-Preze, Ura e Gjoles. Trashesia e ketyre depozitimeve rritet nga qyteti i Tiranes ne drejtim te profilit te Laknas-Valias-Rinas-Gjec-Fushe, verehet nje ligjshmeri e rritjes nga jugu ne Veri dhe nga lindja ne perendim. Ne drejtim te veriperendimit zhavoret ujembajtese zhyten dhe ndahen ne disa shtresa ujembajtese, te ndara nga ndershtresa argjilore. Keto shtresa kane lidhje hidraulike te mira ndermjet tyre. Trashesia e shtreses ujembajtese varion nga 5-10-30 m, trashesi me te madhe ka ne sektoret Selite-Shkolla Teknologjike, Kombinat, Laknas-Berxull dhe ne sektorin Valias- Rinas, Gjec-Fushe deri 40-50 m. Shtresa ujembajtese ka tregues te mire hidraulike, prurja specifike varion nga 10-15l/sek ne Selite, Kombinat, 7-10 l/sek/m ne Fushe-Reze deri ne 12-20 l/sek/m ne Gjec-Fushe, Fushe-Preze. Ne kete akuifer Koeficienti i Filtrimit varion nga 50-100 m/dite ne 200-250m/dite. Thellesia e kapjes se tabanit te akuiferit varion ne nje diapazon te gjere nga 4.8-16-30m ne Tirane-Kombinat, deri 30- 72.5m ne Laknas-Rinas. Ne sipërfaqen me te madhe akuiferi mbulohet nga nje shtrese argjilore me trashesi nga 2-3m e 10-14-17m deri ne 20-30m. Kjo mbulesë suabrgjilore e argjilore ka ujepercjellshmeri shume te vogel por qe luan rol ne ushqimin e tyre nga infiltrimi i reshjeve atmosferike.

Drejtimi i pergjithshem i levizjes se UN eshte Juglindje-Veriperendim me gradient te pjerresise hidraulike $I=0.007-0.009$. Persa i perket karakterit te ujrave nentokesore te ketij akuiferi takohen ujra pa presion nga qyteti i Tiranes dhe me presion por pa vetederdhje ne Laknas, Gjec-Fushe.

Regjimi ujrave nentokesore lidhet kryesisht me faktoret natyrale (qe jane reshjet atmosferike, temperatura, infiltrimi, avullimi) dhe faktoret artificiale (shfrytezimi intensiv dhe ndryshimet ne rrjetin hidrografik). Niveli i UN ka renie te theksuar gjate viteve te fundit si rezultat i shfrytezimit pa kriter te UN. Amplituda e luhatjes se UN varion nga $A= 0.72-8.07m$. Niveli maksimal varion nga $Hs=-1.35-11.05m$. Niveli minimal varion nga $Hs= -3.22-17.85m$

Akuiferi nderkokrrizor ushqehet nga infiltrimet e reshjeve atmosferike ne vecanti ku ato jane pa presion si dhe nga infiltrimet e ujrave sipërfaqesore te lumenjve Tirane, Terkuze. Burim tjetër ushqimi është dhe akuiferi i poro-carje te Tortonianit ku ato jane gjithkund taban i ketij akuiferi, te cilet kane ujembajtje me te vogel, ato drenojne per shkak te presionit te madh qe kane.

Ujerat nentokesore kane veti te mira fiziko-kimike. Fortesia e pergjithshme varion nga 20-260 gjermane, mineralizimi i pergjithshem varion nga 650-900 mg/l. Uji eshte i tipit hidrokarbonat kalciumi. Ujerat nentokesore shfrytezohen per furnizimin me uje te pijshem dhe teknologjik. Ne kete akuifer jane kryer e vene ne shfrytezim nje numur shpimesh per furnizimin me uje te pijshem si stacioni i Pishinave-Selite, Unaza e Re, Kombinat, Laknas, Berxull, Valias, Gjec-Fushe, Rinas. Gjithashtu UN shfrytezohen per uje teknologjik dhe vaditje. (N Puca, A. Pambuku, R. Lika, M. Bele, 2014)




Fig. Zona e studimit ne Harten Tektonike te Shqiperise (shk 1:200 000)

Me poshte paraqiten gjithashtu harta e rrezikut gjeologjik dhe e zonimit gjeologjik te Qarkut Tirane (burimi: ASIG), ku mund te vihet re se trualli ku do te ndertohej objekti i banimit e sherbimeve 9 kate me 2 kate nentoke ndodhet ne nje zone teresisht te pershtatshme per qellime ndertimi dhe nuk paraqet rrezikshmeri gjeologjike.

4. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE MUNDSHME , NEGATIVE, NE MJEDIS, TE PROJEKTIT

Metodika e identifikimit të ndikimeve të mundshme në mjedis

Cdo veprimtari e re që zhvillohet në mjedis shoqërohet me pasoja dhe ndikime që janë pjesë e kompromisit që shoqëria jone ka zgjedhur për t'u zhvilluar. Vlerësimi i ndikimeve të mundshme në mjedis si pasoje e zbatimit të projektit të propozuar është bërë gjykuar mbi faktorët që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e funksionimit, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha nën kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis është analizuar sipas fazave të veprimtarisë si më poshtë:

- Në fazën përgatitore/instalimeve/ndertimit të projektit,
- Në fazën e funksionimit të pikes së karburantit

Cdo fazë e zbatimit të projektit përveç ndikimeve të përgjithshme dhe të përbashkëta edhe ato specifike që varen nga faktorët që i shkaktojnë si p.sh. natyra e proceseve. Është e rëndësishme të kuptohet natyra e këtyre proceseve dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte dhe indirekte, për të vlerësuar drejt ndikimet e cdo veprimtarie që përdor burimet natyrore. Sipas natyrës ndikimet klasifikohen në dy grupe të mëdha:

- Ndikime të kthyeshme,
- Ndikime të pakthyeshme.

Te dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e ndikimit brenda sipërfaqes së cdo objekti dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizim të proceseve komplekse të natyrës dhe rigjenerim të biodiversitetit.

- Ndikimet në ajër

Gjatë funksionimit të stacionit të karburanteve nga qarkullimet e automjeteve vjen deri te rritja e ndotjes së ajrit nga emisioni i gazrave nga automjetet dhe nga avullimi i karburanteve. Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentrim të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NO_x, H_xCy, SO₂ dhe Pb. Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike - meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të komunikacionit në lokacionin ku është ndërtuar stacioni i karburanteve.

Ne strukturën e instalimit nuk përfshihet oxhak, ndaj nuk mund të përlogariten vlerat e volumit maksimal të ajrit apo të ndotësve të shkarkuar në mjedis (pasi ajri shpërhapet në të gjitha drejtimet dhe nuk mund të përlogaritet volumi i tij). Gjithashtu në veprimtari nuk

perfshihet asnje faze djegieje. Shkarkimet e vetme vijne nga automjetet qe frekuentojne instalimin (te cilat gjithsesi gendrojne per nje kohe teper te shkurter, pasi thjesht furnizohen me karburant). Gjithashtu vlen te theksohet se duke marre parasysh vendndodhjen e instalimit (ne ane te nje rruge kryesore), shkarkimet ne ajer ndikohen se tepermi nga automjetet qe levizin ne rrugen perpara objektit).

Instalimi i ploteson te gjitha kushtet teknike dhe punonjesit jane te trajnuar mbi ecurine e veprimtarise, si dhe mbi situatat emergjente, ndaj probabiliteti i ndodhjes se nje situate hipotetike sic eshte derdhja e karburantit, eshte shume i vogel. Per me teper, shoqeria do te monitoroje vazhdimisht sipas legjislacionit ne fuqi, shkarkimet ne ajer qe vijne si pasoje e veprimtarise (parametrat e renditur ne tabelen 6.1.3). gjithsesi, shoqeria eshte e pergatitur per cdo situate emergjente.

- *Ndikimet nga zhurmat dhe vibrimet*

Në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin nervor, në hipertension, në koncentrim të njeriut në punë etj. Lokacioni i stacionit të karburanteve me objektet përcjellëse është i ekspozuar zhurmës së krijuar nga qarkullimi i automjeteve, autocisternave dhe nga funksionimi i pompave dhe kompresorëve për zbrazjen dhe shpërndarjen e karburanteve dhe në mungesë të energjisë elektrike kyçja e shpeshtë e agregatit për energji elektrike. Sipas gjendjes faktike të kompleksit stacionit të karburanteve në lokacionin e analizuar mundë të konstatojmë se niveli zhurmës i shprehur në dB do të jetë nën vlerën e lejuar prej 60 dB .

- *Ndikimet ne toke*

Toka si element themelor natyror është një sistem i përbërë ekologjik i cili nga veprimet e ndryshme mund të vjen deri te degradimi i vlerave themelore karakteristike të saja. Në fazën e shfrytëzimit të stacionit të karburanteve ndotja e dheut është si pasojë e sedimentimit të ndotjeve që sjellën përmes ujërave sipërfaqësore që vijnë nga sipërfaqja e platosë së stacionit të 23 karburanteve dhe nga fundërrimit e komponentëve ndotëse nga ajri, kjo ndotje njihet si ndotje sistematike e dheut gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve pastaj kemi edhe ndotjen aksidentale të dheut e cila vjen si pasojë e avarive të mëdha apo të vogla të pajisjeve. Këto ndotje të dheut evitohen vetëm me largimin e dheut të kontaminuar dhe transportimin e tij në vendet e caktuara aty ku nuk rrezikojnë mjedisin. Nga këto të dhëna vërehet se ndotja e tokës (dheut) afër stacionit të karburanteve varet para se gjithash nga rrjedhja e ujërave të ndotura nga sipërfaqja e platosë së stacionit të karburanteve, konfiguracioni i terrenit dhe nga sedimentimi i ndotjeve prej ajrit në rrethin e stacionit të karburanteve.

Shenim: Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk gjeneron shkarkime ne toke. Gjithashtu, zona ku ndodhet objekti eshte e sistemuar, ndaj edhe ne rast te derdhjes se karburanteve, keto te fundit nuk do te depertonin ne toke, pasi siperfaqja eshte e shtruar (referohuni fotos se meposhtme):



- *Ndikimet ne ujerat siperfaqesore*

Rreziku më potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe ndotja e dheut është nëse vjen deri te shpërthimet e rezervarëve me karburant të vendosur në tokë. Mundësia e derdhjes së derivateve gjatë mbushjes së rezervarëve dhe gjatë toçitjes së derivateve. Pastaj gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve në sipërfaqet shërbyese për komunikacion vjen deri te sedimentimi i materieve ndotëse që është si rezultat i fundërrimit nga gazrat e djegura motorike, i fshirjes së gomave të automjetit, i rrjedhjes së derivateve dhe vajrave nga automjetet e amortizuara , i fundërrimeve nga atmosfera. Vlerat më të larta të ndotjes së ujërave nga sipërfaqet shërbyese të stacionit të karburanteve pritet të jenë gjatë zezonave të dimrit kur kemi hedhjen e kripës nëpër magjistrale. Koncentrimet e ndotësve të sedimentuar në platon e stacionit të karburanteve drejtpërdrejt varet nga zgjatja e periodave të thata dhe pa shi dhe nga dendësia e qarkullimit të automjeteve . Koncentrimi i grimcave të suspenduara është proporcional me sasinë e ujërave nga shpëlarja apo nga të reshurat atmosferike ku koncentracionet më të mëdha janë në 5- 10 minutat e para të shpëlarjes së sipërfaqes së platosë nga personeli apo nga të reshurat atmosferike.

Shenim: Aktiviteti nuk gjeneron shkarkime ne ujrata siperfaqesore prites, per me teper qe ne afersi te instalimit nuk gjenden burime ujore siperfaqesore

- *Ndikimet vizuale dhe ruajtja e peizazhit*

Vleresimi i ndikimit vizual/peizazhit eshte pak a shume subjektiv. Kriteret e ketij vleresimi bazohen ne llojin e zones se ndikuar, kohezgjatjen e ndikimit, si dhe vlerat ekologjike te peizazhit perkates.

- **Ndikimet e mundshme nga zhvillimi i aktivitetit**

| Mjedisi i ndikuar | Ndikimi | Shpjegim |
|------------------------------------|-------------------------------|--|
| Pejsazhi | Ndryshim i pejsazhit te zones | Depozitat ne kete instalim jane nentokesore dhe nuk ka asnje ndryshim ne pejsazh. Vendi eshte i rrethuar dhe i sistemuar. |
| Toke | Ngjeshje e tokes | Nuk do te kete asnje ndikim ne strukturen e tokes perreth zones se aktivitetit. |
| | Erozion i tokes | Nuk do te kete asnje ndikim ne erozionin e tokes perreth zones se aktivitetit. Siperfaqja e zones eshte pothuajse e rrafshet dhe e stabilizuar. |
| | Ndotje e tokes | Shoqeria gjate aktivitetit te saj nuk do te kete shkarkime te lengeta apo te ngurta ne toke. |
| | | Emisione te mundshme vajra dhe karburante qe mund te emetohen ne menyre aksidentale nga mjetet e transportit dhe mjeteve me karburant. |
| Uje | Ndotje e ujerave siperfaqesor | Ndotja e ujerave siperfaqesore mund te shkaktohet vetem ne raste rrjedhjesh nga mjetet e transportit dhe nepermjet shiut te pare rrjedh drejt ujerave siperfaqesore. |
| | Ndotje e ujerave nentokesore | Edhe per ujerat nentokesor vlen i njejti vleresim si per ujerat siperfaqesor. |
| Ajer | Emisione gazesh | Emisione te hidorkarburit mund te kete ne nivele minimale vetem gjate procesit te ngarkim/shkarkimit. Kjo do te jete ne nivele te paperfillshme. |
| | Zhurme, vibrime | Nuk do te kete shkaktim zhurme nga aktiviteti i impiantit. Zhurma e vetme do te jete nga levizja e mjeteve gjate furinizmit te cisternave. Kjo nuk do te kete nje frekuence te shpeshte. |
| Mjedisi biologjik | Flora dhe fauna | Flora dhe fauna e zones nuk do te ndikohet nga aktiviteti i impiantit te depozitimit te hidrokarbureve dhe as nga tregtimi i tij. |
| Mjedisi human | Shqetesim te banoreve | Gjenden pak banesa ne afersi te zones se projektit. Zona do te jete per zhvillim te aktiviteteve ekonomike industriale. |
| Ndikimet tjera te projektit | Ndikimet ne trafik | Zona nuk ka fluks te madh trafiku edhe pse ndodhet ne aks kryesore. Aktiviteti mund te ndikojte ne shtimin e trafikut te zones por megjithate ne nivele te pakonsiderueshme. |
| | Konsumi i energjise | Energjia e perdorur eshte energjia elektrike, dhe vleresohet se nuk ka konsum te larte te energjise. |

5. PERSHKRIMI PER SHKARKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS

Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve

- Shkarkimet ne mjedis

Uji do perdoret per lagjen e territorit per paksimin e pluhurave gjate procesit te levizjes se automjeteve per furnizimin me naftë dhe do sigurohet permes depozitave nga shoqeria. Ujerat e shiut do te sistemohen permes kanaleve perimetrike dhe me pas do i bashkohen kanalizimeve kulluese te zones. Theksojme se keto ujerat nuk permbajnë elemente kimike ndotes. Emetimet ne ajer identifikohen vetem nga procesi i avullimit te lendeve djegese fosile , por edhe si rrjedhoje e ndonje avarie ne sistem nga valvolat e sigurise. Keto lende jane te avullueshme ne temperatura te uleta dhe si rrjedhoje ne kushte normale atmosferike, sidomos gjate veres avujt e karburanteve perhapen ne mjedis. Keto avuj jane me te rende se ajri ne siperfaqen e tokes dhe si rrjedhoje kane prirjen qe te depozitohen ne siperfaqet me te uleta te tokes, si gropa, siperfaqe ujore etj. Me kushtet atmosferike keto avuj shperndahen dhe nuk perbejne asnje problem per mjedisin e zones. Nuk vleresohen me ndikime domethenese. Sasi te tilla i asimilon vete atmosfera nepermjet proceseve natyrore te klimes. Tek punonjesit qe mund te jene te ekspozuar ne keto shkarkime rekomandohet perdorimi i maskave kundra gazeve te demshem. Nje ndikim i rendesishem ne mjedisin atmosferik do te vleresohen rastet e renies se zjarrit ne objekt dhe djegia e karburantit. Kjo mundesi eshte e rralle por jo e perjashtuar. Nje ngjarje e tille do te shkaktonte ndotje serioze ne ajer, emetimin e sasive te medha te gazeve te demshem ne nje zone te caktuar dhe nje shtrirje siperfaqesore relativisht te madhe. Gjithashtu mjetet rrugore qe qarkullojne duhet te jene konform normave te percaktuara dhe te testuara nga Qendra e Kontrollit Teknik te automjeteve e te pajisura me certifikaten e Vertetimit Teknik nga IQT. Depozitat e naftës nuk do të jenë burim emetimi tegazeve ndotese , për arsye se nuk ka proces djegie që mund të emetohen gaze në atmosferë. Gjithashtu, parashikohet që nuk do të shkaktohet pluhur gjatë funksionimit sepse të gjitha hapsirat dhe sheshet ku do të kalojnë dhe do të parkohen autobotet do të jenë të shtruara mebeton dhe në disa pjesë me asfalt

Niveli i zhurmave te ketyre automjeteve , eshte i atij niveli qe nuk influencon si per te punesuarit dhe per banoret dhe gjallesat per rreth tij. Fenomene te tilla si vibracion zhvillimi i aktivitetit nuk do te kete. *Prodhimi i mbetjeve*

Mbetjet mund te gjenerohen si gjate fazes se ndertimit ashtu edhe gjate fazes se funksionimit. Sasite me te medha te mbetjeve mund te gjenerohen gjate fazes se ndertimit, mbetje te tilla si: dhera natyrore te germuar, mbetje urbane, mbetje te lengshme, etj. Kontraktori ka per detyre zbatimin e praktikave te menaxhimit te mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme, duke bere:

- identifikimin dhe ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
- percaktuar vendndodhjen e perkohshme ne kantier;
- percaktuar menytrat e trajtimit/transferimit te mbetjeve;
- depozitimin e tyre perfundimtar (vendndodhjen);

Mbetjet e rrezikshme dhe jo te rrezikshme duhet te jene te rregulluara ne perputhje me kerkesat e Ligjit Nr. 10 463, date 22.09.2011 “Per Menaxhimin e Integruar te Mbetjeve”.

Mbetjet qe krijohen do te jene vetem mbetje me karakter urbane nga aktiviteti i perditshem i punonjesve. Keto mbetje do te grumbullohn ne kosha plastike dhe me pas do te depozitohen ne vendin e caktuar nga bashkia.

6. TE DHENA PER SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPESINORE TE NDIKIMIT NEGATIV NE MJEDIS

Ky projekt nuk ka dhe nuk do te kete ndikime negative ne shtrirje hapsinore, madje dhe ne zonen ku do te zhvillohet projekti keto ndikime do te jene te pa konsiderueshme.

7. MASAT E MUNDSHME PER SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

- Mundesia e zbutjes se ndikimeve dhe agrumentimet perkatese

Ndikimet e mundshme negative kerkojne hartimin e masave zbutese dhe rikuperimin sa me te madh te tyre ne aspektin mjedisor e social. Kjo realizohet me ane te kater metodave te mundshme per marrjen e masave zbutese:

- Parandalimi i ndikimeve te mundshme;
- Reduktimi i ndikimeve te mundshme;
- Zbutja e ndikimit te mundshem;
- Monitorimi;

Lloji i rekomanduar i masave zbutese te ndikimit varet nga nje sere faktoresh, perfshire zbatueshmerine teknike, prakticitetin, burimet dhe kapacitetin e disponueshem, koston dhe nese rikuperimi i propozuar eshte ne perputhje me planin apo programin e propozuar.

- **Masat zbutese per ndikimet ne cilesine e ajrit**

1. Lënda djegëse e cila do të përdoret nga mjetet dhe automjetet që do të operojnë gjatë fazës furnizimit dhe transportit të naftës të jëtë e një cilësie të mirë.
2. Mjetet dhe automjetet që do të përdoren gjatë fazës së operimit do tu jetë kryer serviset teknike e duhura.
3. Mjetet dhe automjete që do të përdoren nuk do të jenë të amortizuara të cilat mund të shkaktojnë emetime të gazeve në nivele të larta në atmosferë.

4. Të realizohet spërkatja e ambienteve në mënyrë që të reduktohet sasia e pluhurit që mund të shkaktohet gjatë livizjes së automjeteve.
5. Ambientet përreth terminalit të spërkatën me ujë për të shmangur pluhurin

- **Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në tokë**

Në bazë të analizës së vlerësimit ndikimet në cilësinë e tokës do të hasen vetëm në rast se do të ketë shkarkime aksidentale të hidrokarbureve të cilat ndikojnë në ndotjen e asaj sipërfaqeje. Madhësia e këtij ndikimi do të jetë në varësi të madhësisë së aksidentit. Kompania duhet të aplikojë masa për parandalimin e cdo aksidenti në mjedis.

- Kompania të përcaktojë një vend të caktuar dhe të pajisuar me kosha për grumbullimin e mbetjeve urbane.

- Cdo lëndë ndihmëse do të magazinohet në kushte optimale në mënyrë që të mos ndodh asnjë lloj shakrrimi aksidental në tokë.

-Gjatë perimetrisë së sipërfaqes ku do të operojë kompania të hapen kanale kulluese në mënyrë që të sistemohen ujërat sipërfaqësorë të sheshit dhe të kontrollohet cdo lloj derdhje brenda sipërfaqes së projektit. Kompania operon më ndërgjegjësimit të lartë mjedisor. Kjo duket edhe nga ambientet brenda territorit ku ajo operon janë të shtruara me beton, të pastra dhe asnjë lloj mbetje nuk është e përhapur në tokë. Ky lloj menaxhimi shmang edhe ndotjen e tokës.

- **Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në ujrat sipërfaqësorë**

Operimi i këtij lloj projekti nuk gjeneron ujra teknologjik dhe për këtë arsye nuk ndikon në mënyrë të drejtë për drejtë në ujrat sipërfaqësorë.

-Të sistemojë ujrat sipërfaqësorë të sheshit në të cilin do të operojë.

- **Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në biodiversitet**

Subjekti në fazën e operimit të kryejë monitorim periodik të nivelit të zhurmave që gjenerohen, në mënyrë që ato të mos jenë shqetësuese për mjedisin natyror.

- Rrugët dytësore dhe e gjithë infrastruktura që do të përdorë subjekti për zbatimin e këtij projekti të spërkatën në mënyrë periodike për të ulur nivelin e përhapjes së grimcave të ngurta në atmosferë.

- Ndricimi i zonës ku do të zhvillohet projektit gjatë natës të projektohet në atë mënyrë që të mos jetë shqetësues për kafshët e egra.

- **Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në peisazh**

Për zbutjen e ndikimeve nga prania e projektit në peisazhin natyror kompania të zbatojë këto masa gjatë fazës operimit:

- Përreth sheshit të mbillen pemë të larta

- Mjedis të mbahet i sistemuar dhe i pastër
- Të shmangen shkatimi dhe përhapja e pluhurit në atmosfere
- Të shmangët grumbullimi i mbetjeve për një kohë të gjatë.

- **Masat ekzistuese per parandalimin e aksidenteve ose sistemet e reagimit ne rast emergjencash.**

Sherbimi i Sigurise se Kompanise operon ne kushtet e nivelit te sigurise Nr.1 dhe ka si mision te saj Garantimin e Sigurise se Jetes dhe te aktivitetit ekonomik te kompanise. Ajo e realizon ate: a. Nepermjet zbulimit dhe vleresimit ndaj kercenimeve te sigurise dhe marrjen e masave paraprake kundrejt incidenteve qe prekin sigurine e kompanise; b. Nepermjet percaktimit te detyrave konkrete dhe pergjithesive funksionale te Sherbimit te Sigurise per te vendosur sigurine; c. Nepermjet sigurimit te nje kembimi te shpejte dhe objektiv te informacioneve me Policine e Shtetit ; d. Nepermjet pasjes se nje metodologjie te vleresimit te gjendjes se sigurise, per te vepruar siç duhet ne rastet e ndryshimit te nivelit te sigurise. Sherbimi i Sigurise eshte pergjegjese per ruajtjen, mbrojtjen, sigurine dhe zhvillimin ne kushte normale te operacioneve te ngarkimit te automjeteve me lende djegese Per te parandaluar dhe perballuar situata emergjence me personelin e sherbimit dhe ate punonjes te kompanise ,jane programuar dhe zhvilluar tema stervitje, alarme e ushtrime ne drejtim te ndergjegjesimit per zjarrin; te dallimit te objekteve dhe personave te dyshimte; te kercenimit me bombe apo pakot e dyshimta me synimin, qe,çdo punonjes i kompanise si me dhe, pa detyra te veçanta sigurie te ndergjegjesohen me detyrat e sigurise

-Rezervarët për lëndë djegëse të lëngtë dhe të gazta (butan, propan) do të jenë të prodhuar sipas standardeve të caktuara dhe të vendosur po ashtu sipas standardeve

-Stacioni i karburanteve duhet të pajiset me sistemin sekondar për mbledhjen e derdhjeve aksidentale.

-Stacioni i karburanteve duhet të pajiset me sistemin për mbledhjen e avujve që lirohen nga karburantet

-Është obligim që rezervarët e karburanteve të kontrollohen brenda 5 viteve të para të punës për të përcjell dëmtimet e trashësisë së mureve nga veprimi korroziv, pas 5 viteve kontrolli duhet bërë për çdo dy vite.

-Për të zvogëluar mundësin e rrezikut rekomandohet që rezervari i lëndëve djegëse të gazta (butan, propan) nëse rezervari vendoset mbi tokë, të rrethohet me mur statik

- **Masat specifike per parandalimin e zjarrit**

Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit ndahet ne:

- *Mbrojtje aktive*, e cila ka te beje me instalimin e dispozitivave shuares sikurse jane hidrantet e brendshem dhe te jashtem, fikset me shkume pluhur e gaz, sprinklerat, detektoret e tymit, flakes etj.
- *Mbrojtja pasive*, e cila ka te beje me materialet e strukturave te nderteses, te cilat vleresohen ne baze te rezistences qe paraqesin karshi zjarrit, seksionet e ndarjeve, sistemin e daljeve te emergjences, ventilimit te tymrave etj.

Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit realizohet ne baze te dimensioneve, specifikimeve dhe kualitetit te materialeve te percaktuar ne vizatim, instruksioneve te Inxhinierit perfaqesues, standardeve dhe normave lokale, si dhe ato te vendeve te Komunitetit Evropian. Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit respekton te gjitha kerkesat e detyrueshme shteterore qe kane te bejne me normat/ standardet qe jane ne fuqi aktualisht ne Shqiperi, si dhe normat italiane CNVVF/ CPAI UNI 9485. Gjate procesit te dizenjimit dhe aplikimit te sistemit kontaktohen autoritetet vendore te MZKSH per te siguruar nje testim dhe aprovim te ketij instalimi.

○ **Substancat shuarese te zjarrit**

Duke marre ne konsiderate karakteristikat e nderteses dhe aktivitetet qe zhvillohen, do te perdoren substanca shuarese si me poshte:

- Uje (instaluar ne pjesen e jashtme)
- Shkume (prane depozitave dhe zyres)

- **Pajisjet e shuarjes se zjarrit**
- Hidrante ne brendesi te godines (nuk aplikohen)
- Hidrante jashte godines (aplikohen)

Faktoret percaktues:

Faktoret percaktues qe jane marre ne konsiderate gjate projektimit duhet te jene:

- Natyra dhe permasa e zjarrit
- Madhesia e zones qe do te mbrohet
- Mundesia e perhapjes me shpejtesi e zjarrit
- Kerkesat dhe normat sipas UNI 10779 si dhe ato qe jane ne fuqi ne legjislacionin shqiptar.

Furnizimi me uje i sistemit te mbrojtjes nga zjarri

Pajisjet e shuarjes se zjarrit duhet te disponojne sasine complete te ujit te nevojshem per te luftuar zjarrin ne momentin kur ai shfaqet. Kjo do terealizohet nepermjet instalimit te hidranteve te ujit jashte nderteses. Keto nga ana e tyre do te duhet te furnizohen me sasine e duhur te ujit, si dhe presionin e mjaftueshem.

Burimi i furnizimit me uje

Furnizimi me uje konsiston ne nje nga kombinimet e meposhtem:

- Lidhja me rrjetin e ujit urban
- Rezervuari vertikal, i lidhur me nje pompe me seksion te pershtatshem per furnizimin e impiantit.




Fig. Projekti i mbrojtjes nga zjarri

- Programi i monitorimit te ndikimeve ne mjedis gjate zbatimit te projektit

Objektivi themelor i ketij seksioni eshte qe te ofroje rekomandime te pershtatshme per mbrojtjen e shendetit te punonjesve, komunitetit lokal, si dhe mbrojtje te elementeve mjedisore te zones se ndikuar nga zhvillimi i projektit (ujera siperfaqesore, ujera nentokesore, ajer, toke, etj). Monitorimi ne thelb eshte procesi i vzhgimit dhe zbulimit te ndryshimeve, nese ato do te ndodhin, gjate nje periudhe kohe te caktuar. Kontraktori do te pergatise Planin e Menaxhimit Mjedisor (PMM) dhe Panin e Rehabilitimit (PR).

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga vete kompania ata elemente qe realisht mund te identifikohen, maten, regjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit.

Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje rregjister qe administrohet nga vet kompania dhe do te dorezohen ne Drejtorine Rajonale te mjedisit sa here ju kerkohet, sipas proceduarve ligjore dhe rregulloreve. Persa i perket monitorimeve te komponenteve te cilat shoqeria nuk i ben dot matjet do te lidh kontrate me subjekte me laboratore mjedisor te akredituar te cilet do te monitorojne ecurine e shkarkimeve te ketyre komponenteve.

Plani i monitorimit konsiston ne:

- Monitorimin e ndikimit te zhurmave qe shkaktojne makinat e transportit dhe makinerite e

punes brenda zhvillimit te aktivitetit. Per te ulur nivelin e zhurmave ne normat e pranueshme, makinat pajisen me amortizues te zhurmave (selenciator).

- Subjekti do te beje cdo gjashte muaj kontrollin e nivelit te pluhurit, zhurmave dhe gazeve ne ambient dhe do te informoj Drejtorise Rajonale te Mjedisit.
- Subjekti merr persiper sigurimin e ecurise normale te punes dhe ruajtjen ne vazhdimesi te mjedisit deri ne mbylljen e aktivitetit.

| Nr | Natyra e monitorimit | Frekuenca | Analiza |
|----|--|--------------------------------|--|
| 1 | Monitorimi i shkarkimeve te gazta nga aktiviteti | Periodike (Cdo 6 muaj) | SPM, NO _x , CO, SO _x 3 pika |
| 2 | Monitorimi i zhurmes se shkaktuar | Periodik (raportim cdo 6 muaj) | 3 pika te ndryshme Zhurma (dbA) nga aktiviteti i |

Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit te Mjedisit

PMM paraqet nje perpjekje te integruar te elementeve te shfrytezimit, planifikimit, mirembajtjes, mbikqyrjes dhe kontrollit te mjedisit nepermjet marrjes se masave zbutese gjate fazes se ndertimit. Suksesi i PMM varet nga metoda dhe teknikat e menaxhimit qe do te zbatohen gjate fazes se ndertimit nga Kontraktori. PMM-ja liston ndikimin e mundshem, masat zbutese, autoritetin/et pergjegjese per ndermarrjen e monitorimit, cfare lloji monitorimi kerkohet si dhe frekuencen e monitorimit. Nese PMM zbatohet ne menyre korrekte dhe te plote ndikimet mund te zvogelohen/shmangen ne mase te madhe, thuajse plotesisht. PMM zhvillohet nga Kontraktori nepermjet specialisteve mjedisore te punesuar prej tij, te cilet bazuar ne VNM e objektit dhe ndikimeve te mundshme sipasoje e procesit ndertimor, japin sugjerimet e tyre per zgjidhjen e ceshtjeve problematike ne menyre qe ndikimi ne mjedis te jete sa me i vogel.

PMM eshte nje dokument i rendesishem dhe kopjet e tij duhet te mbahen ne terren (kantier) nga personat pergjegjes per zhvillimin e projektit (perfaqesuesit e Kontraktorit) per te siguruar pajtueshmerine gjate fazes se ndertimit dhe gjate fazes se funksionimit. Nje nga aspektet kryesore te PMM eshte ndergjegjesimi i punonjesve per ceshtjet e mjedisit. Stafi menaxherial duhet te perfshije edukimin e punonjesve nepermjet trajnimeve te vazhdueshme, madje ne shume raste kerkohet edhe informimi dhe edukimi i banoreve lokale. Per shembull, punetoret te cilet do te kryejne rehabilitimet/mbjelljet duhet se pari te trajnohen dhe informohen nga inxhinieri i mjedisit/inxhinieri i pyjeve/biologu per procedurat qe duhet te ndjekin per kete proces. Se dyti, eshte e rendesishme qe banoret lokale te jene te informuar per strategjite dhe masat zbutese qe do ndermerren, ne menyre qe ata te kuptojne natyren e projektit dhe sesi trajtohen problemet e ndryshme ne lidhje me token, ujerat, etj. Kjo perqasje ne shume raste do te shmangte edhe problematikat me komunitetin dhe ankesat ne lidhje me zhvillimin e projektit.

Gjithashtu vlen te theksohet se pjesa me e rendesishme e menaxhimit te mjedisit gjate fazave te ndryshme te projektit eshte evidentimi i kushteve te mjedisit para fillimit te punimeve me ane te Raporteve Paraprake te Mjedisit (fotografi, pershkrimte mjedisit ekzistues, etj) dhe evidentimi i

kushteve te mjedisit pas perfundimit te punimeve (fotografi, pershkrim te mjedisit, pershkrim i rehabilitimit te kryer, etj)

| Nr. | Monitorimi | Parametrat qe do te monitorohen | Frekuenca | Pergjegjesia |
|-----|---|--|-----------|--------------|
| 1 | Cilësia e Ajrit | PM10,TSP,SO2, NOx, CO, CO2 | Periodike | KLEIDI |
| 2 | Emetimi i zhurmave | Niveli i zhurmave në dB | Periodike | KLEIDI |
| 3 | Monitorim i zbatimit të kushteve të lejes mjedisore | Monitorim i kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në aktmiratimin e lejes mjedisore | Periodike | KLEIDI |

8. NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDISIN NDERKUFITAR (NESE PROJEKTI KA NATYRE TE TILLE)

Konventa “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis ne kontekst nderkufitar (Konventa ESPOO)” ka per qellim vleresimin e ndikimit ne mjedis te projekteve qe zhvillohen kryesisht ne zona nderkufitare dhe qe mendohet qe mund te kene ndikim ne mjedisine vendeve fqinje. Shqiperia eshte pale ne kete Konvente qe prej 4 Tetorit te vitit 1991.Kjo Konvente synon bashkepunimin midis shteteve per mbrojtjen e mjedisit nderkufitar nga projektet me ndikim ne mjedis nepermjet:

- Njoftimit paraprak te shtetit, mjedisi i te cilit mund te ndikohet nga nje projekti caktuar. Njoftimi behet nga Shteti, i cili synon te zbatoje projektin ne territorin e tij, icili e fton Shtetin qe mund te ndikohet te marre pjese ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis te projektit te propozuar, duke i dhëne kohe te mjaftueshme dhevene ne disponim raportin e vleresimit te ndikimit ne mjedis te projektit te propozuar;
- Duke e njoftuar Shtetin e ndikuar per vendimin perfundimtar per projektin dhe kushtet per mbrojtjen e mjedisit qe duhet te respektohen.

Gjthashtu nga Shqiperia jane ratifikuar edhe amendamentet e saj, vendimet II/14 dhe III/17, nepermjet Ligjit Nr. 9478, date 16.02.2006 "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne vendimet II/14 dhe III/17, Amendamentet e Konventes se ESPOO-s "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis, ne kontekst nderkufitar”.

Subjekt i kesaj konvente jane te gjitha projektet e listuara ne shtojcen I te kesaj Konvente, ose me sakte ne Amnedamentin e dyte te kesaj Konvente, ku jane listuar te gjitha projektet qe i nenshtrohen kerkesave te kesaj konvente.

Projekti i propozuar nuk ben pjese ne shtojcen 1 te kesaj konvente dhe mbi te gjitha nuk do te ushtrohet ne nje territor kufitar.

9. PERFUNDIME DHE REKOMANDIM

Ne perfundim te ketij studimi arrijme te nxjerrim disa perfundime te rendesishme dhe rekomandime per te bere te mundur zbatimin me ndikime sa me te vogla ne mjedis te projektit . Ushtrimi i ketij aktiviteti behet konform te gjitha rregullave te sipermarres se lire te biznesit privat vendas.

Rekomandime

- Zhvilluesi duhet te zbatoje me rreptesi te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni i siperctuar;
- Mbetjet e rrezikshme, nese gjenerohen te dorezohen sipas kerkesave te Vendimit te Keshillit te Ministrave VKM Nr. 371, date 11.06.2014 “Per percaktimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme, dhe miratimin e dorezimit te mbetjeve te rrezikshme”;
- grumbullimin e kontrolluar te mbetjeve jo te rrezikshme;
- ndarjen e mbetjeve te parrezikshme (te llojit urban) dhe ato jo urbane;
- ambalazhimin, etiketimin, magazinimin, grumbullimin, trajtimin, transportimin dhe asgjesimin ne menyre te pershtatshme, te mbetjeve;
- shpenzimet e transportit, asgjesimit ose riciklimit te mbetjeve. Kjo pergjegjesi eshte e pashmangshme dhe e pavarur nga pergjegjesia e ndonje personi te trete te ngarkuar nga prodhuesi, per te ndermarre keto veprimtari;
- te gjitha demet e shkaktuara ne menyre direkte ose indirekte ne mjedis dhe ne shendetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjesimit te mbetjeve te krijuara prej tyre.
- Te lejohet hyrja vetem e personave qe kane kualifikim per te administruar mbetjet.
- Te kryhen kontrole periodike dhe te mbahen shenime per cdo defekt dhe avari.
- Instalimi korrekt i impiantit, me standarte bashkohore europiane per depozitimin e GLN
- Vezhgim dhe kualidim i vazhdueshem i te gjithe teknologjise se projektit, saracineska, tubo, valvola, tapa, guarnicione etj;
- Kontroll i sheshit te levizjes se mjeteve per mbetje te hidrokarbureve
- Perdorimi dhe ruajtja me pergjegjesi i te gjithe infrastrukturesdhe makinave sipas skemes dhe rregullave teknologjike

- Mjetet e transportit duhet te levizin me shpejtesi te ulet gjate transportit si dhe mjetet duhet te pastrohen vazhdimisht. Nevojitet te kontrollohet vazhdimisht gjendja e tyre teknike, dhe te kryen serviset periodike te nderrimit te filtrave.

Hartoj Raportin

Emanuela Arifi



Ekspert i VNM dhe Auditimit Mjedisor

